

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7427 E enjte 1 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Thonë që sarkazma del nga shpirtrat e vrarë dhe mua, si shumë shqiptarë patriotë në atdheun tim, më dhemb këto ditë tek ndjej për shitje dy nga ...
Vijon në faqen 20

Nga GAZMIR TAHIRI

Dhimbja për detin dhe një histori çame



Opinion i Ditës

Prej dy ditësh një pjesë e bashkësisë së shqiptarëve janë të trazuar dhe shumë të goditur prej lajmeve që përhapen në bazë të deklaratave qeveritare ...
Vijon në faqen 22

Nga MYSLIM PASHAJ

Ujku, gjurma, pakti detar dhe akti i sotëm diplomatik



INTERVISTA

Flet ish-komandanti i Forcave Detare
"Greqia e ka kufirin 6 milje me Italinë dhe Turqinë, pse me ne e duan 12 milje?"

Vladimir Beja udhëhoqi negociatat për kufijtë Shqipëri-Itali: Keqardhje që s'ka transparencë. 12 miljet Greqisë nuk ia ka pranuar as SHBA-ja
Nga DARINA TANUSHI
Vladimir Beja, ish- Komandanti i Forcave Ushtarake Detare të RSH dhe ish-kryetari i grupit të ekspertëve në Marrëveshjen me Italinë shprehu ...
Në faqen 3

EKSTRADIMI I FINANCIERIT TE HABILAJVE, PD PUBLIKON DOKUMENTIN, KLD HETON GJYQTARIN

"SHPERTHEN" LU: KU JANE REZULTATET KUNDER KRIMIT?

Thirrja e ambasadorit të SHBA për politikanët, policët dhe prokurorët: Komuniteti ndërkombëtar kërkon rezultate konkrete përpara pranverës



(Në foto) Ambasadori Amerikan në Tiranë Donald Lu
Në faqet 4-5

QEVERIA: 27 KATEGORITE
Punësimi social, nga ish-të dënuarit të personat me afësi të kufizuar, kush përfiton
Në faqen 3

FLET AVOKATI
Vrasja e Devi Kasmit, në pranga miku i tij Mario Meshini, çfarë zbuluan kamerat
Në faqen 9

VENDIMI I BASHKIAKEVE
Shpërndahen 120 banesa për familjet e pastreha në Tiranë, lista e plotë me përfituesit
Në faqen 12

EKSPOZITA
Kosova i kërkon Shqipërisë orën dhe xhamadanin e Isa Boletinit
Në faqen 17

MJEKU POPULLOR: ME TERFIL LINI DUHANIN



Ylli Merja: Si të shpëtoni nga stresi ankthi e depresioni, përzjerjet e duhura
Në faqen 13

Shoqërohen në polici kryebashkiaku dhe 40 persona, Muharrem Rama: Sulm i paprecedent

"Luftë" mes PS e PDIU në Dibër, kërcet shkopi i bejsbollit

Emërimi i një drejtori nga Jugu, përfundojnë në spital 4 punonjës

Emërimi i tepelenasit Edrini Mataj, drejtor i Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Dibërës si dhe shkarkimet që ai kishte paralajmëruar se do të bëheshin në administratë ka çuar në përplasje mes socialistëve dhe çamëve. Kjo për faktin se nga shkurt



timet do të prekeshin punonjësit e bashkisë të sjellë nga PDIU. Përplasja fizike mes punonjësve të bashkisë ka nisur mëngjesin e djeshëm, gjatë mbledhjes gjatë mbledhjes së administratës. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me ...
Në faqen 11

PAKTI DETAR ME GREQINE REAGIMET

Përplasja, ish-kryeministri akuzon qeverinë për mungesë transparence

Pakti me Greqinë, Berisha: I falën naftën. Bushati: Mos përmend detin

Ministri: Do rikthejmë dinjitetin që ti ia shkele Shqipërisë

Darina Tanushi

Deklarata e ministrit të Jashtëm Nicos Kotzias se Shqipëria ka rënë dakord për t'i njohur ujërave greke 12 milje, përplasi dje ish-kryeministrin Sali Berisha dhe ministrin për Evropën e Punët e Jashtëm, Ditmir Bushati. Përmes një statusi në faqen e tij të 'Facebook'-ut Berisha tha se Rama i ka falur Greqisë fusha me gaz dhe naftë në Jon dhe Mesdhe. Ai akuzoi qeverinë se kjo marrëveshje po bëhet në mungesë të plotë transparence. "Pas kësaj deklarate Rama nxori Ditëzin për të deklaruar dhe mashtruar shqiptarët se marrëveshja është dhe do jetë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Rama vetë pohoi se marrëveshja me Greqinë është arritur, pa sqaruar cila ishte kjo marrëveshje, por pa përgënjeshtuar, dhe indirekt duke pranuar atë që deklaroi ministri i Jashtëm grek në parlamentin e vendit të tij.", -tha Berisha. Por, i menjëhershëm ishte reagimi i vetë ministrit Bushati që dje, ndodhej në Danimarkë, për një vizitë zyrtare. "Sali! Unë jam dega e një trangu që s'u përkund kurrë në 500-vjet histori. Mos e përmend detin se aty do nxijë përjetë faqja jote e zezë! Kjo qeveri ku kam nderin të jem, do rikthejë dinjitetin që ti ia shkele Shqipërisë e do hapë një faqe të re partneriteti strategjik me fqinjin", -u shpreh ministri Bushati. Ndërkohë në regjimin e tij, ish-kryeministri Sali Berisha tha: "arritjen e kësaj marrëveshjeje, në të cilën Shqipëria humbet të paktën 1 mijë km katror sipërfaqe detare, Edi Rama e mbajti në fshehtësi të plotë dhe shqiptarët e morën vesh arrijten e saj nga informimi që bëri në parlamentin e vendit të tij ministri i Jashtëm grek Nikos Kotzias, i cili deklaroi se me marrëveshjen e arritur Greqia zgjeron me 12 milje ujërat e saj territoriale". "Çilido që di të lexojë deklaratat e mësipërme e ka të qartë se marrëveshja është



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtëm, Ditmir Bushati



Ish-kryeministri Sali Berisha

MIMI KODHELI

"Ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe i mbetemi këtij vendimi, i vetmi njeri që mund të përgjigjet për këtë është ministri Bushati, meqenëse ka një interes të madh publik lidhur me vazhdimësinë e bisedimeve. Ne do të jemi sërish këtu për t'i rikërkuar ministrin një shpjegim", -tha dje, kryetarja e Komisionit të Jashtëm.

Presidenti i Republikës po ndjek me vëmendje negociatat

Meta: Do të veproj sipas Kushtetutës për marrëveshjen e detit me Greqinë

Presidenti Ilir Meta deklaroi dje, se do të veprojë konform Kushtetutës dhe kompetencave e përgjegjësiave politike e ligjore në lidhje me marrëveshjen e detit që po negocohet nga qeveria shqiptare dhe ajo greke. Në një reagim, në rrjetin social, "Facebook", pas komenteve të shumta të qytetarëve, Meta tha se është duke ndjekur me vëmendje dhe me kujdes çështjen e marrëveshjes së re për detin midis Shqipërisë dhe Greqisë. "Të dashur komentues, i jap të drejtë shtetësismit tuaj, të nxitur edhe nga lajmet dhe deklaratat e



ndryshme lidhur me marrëveshjen e detit me Greqinë. Unë jam duke ndjekur me shumë vëmendje dhe kujdes, por jo me nxitim,

të arritur dhe se Edi Rama ka pranuar hartën e palës greke, në të cilën, sipas burimeve të sigurta, përveç zgjerimit në 12 milje të kufirit detar të Greqisë, Rama i falë vendit fqinj fushat më të mëdha të gazit por dhe naf-tës të Jonit dhe Mesdheut", -tha më tej, Berisha.

VIZITA

Ndërkohë gjatë vizitës së

këtë çështje të rëndësishme dhe si President i Republikës do të veproj konform Kushtetutës dhe kompetencave e përgjegjësiave politike, ligjore e publike ndaj kësaj çështjeje", u shpreh dje, Presidenti Meta. Sipas tij, "Marrëdhëniet me Greqinë janë shumë të rëndësishme dhe trajtimi i tyre me transparencë, gjithëpërfshirje dhe konform Kushtetutës, ligjeve ndërkombëtare dhe inter-save reciproke të të dy vendeve do të kontribuonte pozitivisht për një progres të tyre, më të fortë, të qëndrueshëm dhe të dëshiruar nga të gjithë".

cesin e reformave në Shqipëri, me fokus reformën në drejtësi dhe progresin e bërë në plotësimin e pesë prioritetëve. Ministri Samuelson, duke konfirmuar mbështetjen e Danimarkës për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe duke vlerësuar punën e bërë, u shpreh se Komisioni Evropian është institucioni më i



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtëm, Ditmir Bushati dhe ministri i Jashtëm grek, Nicos Kotzias

"Distanca 12 milje", këshilltari i Bushatit: Nuk e di nga e gjeti Kotzias

Glevin Dervishi, këshilltar në MEJP tha dje, në News24 se deri më tani është arritur dakordësia mes palëve për arrijten e një marrëveshjeje për çështjen e detit, dhe nuk është kaluar në detaje specifike. "Unë nuk di të them nga e gjeti ministri grek 12 mijë miljet. Por çështja është se ne duam të arrijmë drejt një marrëveshjeje që të përfshijë komponentët kryesorë. Në momentin që palët kanë gjetur gjuhën e përbashkët për të arritur një marrëveshjeje, atëherë palët do të përgatiten për ngritjen e grupeve të ekspertëve dhe realizimin e procedurave. Nuk ka një afat fiks sa kohë mund të kërkojnë procedura. Deri më tani secila palë ka bërë një lloj vlerësimi dhe analize", -tha Dervishi.

Negotiatat me Kotzias, Idrizi: I kërkova takim Bushatit, por s'reagoi

Kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi, është shprehur se nuk ka transparencë në lidhje me negociatat mes palës shqiptare dhe asaj greke për "çështjen çame". I ftuar në rubrikën "Opinion" në studion e lajmeve në News24, Idrizi tha se çështja e varrezave të ushtarëve grekë, është trajtuar joprofesionalisht nga pala shqiptare. Në lidhje me "çështjen çame", Idrizi tha: "Unë kam kërkuar të takoj z.Bushati që pas takimit të tij në Kretë me Kotzias dhe të flisja me të për shumë çështje, por nuk ka reaguar. Mirë që nuk sqaron se çfarë bëhet, por thotë dhe që çamët nuk përfitojnë nga ligji i luftës. Mbi shqiptarët e Çamërisë kur iu hoq nënshtrësitë greke dhe iu vu shqiptarja, pati ndikim ligji i luftës. Shqiptarët e Çamërisë edhe sot ndalohen në Greqi. Nëse Bushati s'ka informacione për këto, jemi gati ta informojmë," -u shpreh Idrizi.

mirë për të vlerësuar progresin dhe se Danimarka do të mbështesë rekomandimin e Komisionit Evropian në raportin e tij për Shqipërinë në muajin prill. Ministri Samuelson shprehu vlerësim për bashkëngjitjen e plotë të Shqipërisë me vendimet e BE-së në politikën e jashtme dhe të sigurisë. Ministri Samuelson vlerësoi rolin konstruktiv

të Shqipërisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si faktor i qëndrueshëm stabiliteti dhe bashkëpunimi rajonal. Në këtë kontekst, ministrat nënvizuan rëndësinë e forcimit të perspektivës evropiane të rajonit të Ballkanit, përmes një vizioni të qartë dhe gjithëpërfshirës në qartësimin e zgjerimit që pritet të miratohet së shpejti.



Ish-komandanti i Forcave Detare: Keqardhje që s'ka transparencë

Beja: S'duhet të pranojmë shtrirjen 12 milje të Greqisë

"Me Italinë e Turqinë e ka 6 milje. 12 nuk ia pranoi as SHBA-ja"

Darina Tanushi

Vladimir Beja, ish-Komandanti i Forcave Ushtarake Detare të RSH dhe ish-kryetari i grupit të ekspertëve në Marrëveshjen me Italinë shprehu dje, keqardhjen që në marrëveshjen e re për kufirin ujor të Shqipërisë me Greqinë nuk ka transparencë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" ai u shpreh se, "njohja dhe pranimi nga Shqipëria që Greqia t'i shtrijë ujërat e saj territoriale, në 12 milje është i papranueshëm për ne si një parim jo i sinqertë dhe nuk na vë në kushte të barabarta, siç deklaroi ministri Bushati". Sipas tij, shtrirja duhet të mbetet në 6 milje, ashtu siç e ka Greqia edhe me Italinë, pasi shtrirjen 12 milje nuk ia njohu as SHBA.



Vladimir Beja, ish-Komandanti i Forcave Ushtarake Detare

KESHILLA

Pala shqiptare nuk duhet të përsërisë gabimet e bëra, sidomos ato që kanë qenë të dukshme dhe të vërtetuara tashmë nga grupi i ekspertëve, të cilët kanë gabuar rëndë, në mosmarrjen parasysh të eksperiencës së mëparshme në marrëveshjen me Italinë, në ngutjen për ta bërë sa më shpejt këtë marrëveshje dhe diku dhe për mungesë integriteti.



"GSH" denoncoi paktin e parë me Greqinë

Marrëveshja 2009, Basha-Bakojanis, Shqipëria do humbte mbi 300 km katrorë

Në prill të vitit 2009, ish-ministri i Jashtëm, Lulzim Basha nënshkroi me homologen tij, greke Dora Bakojanis pikërisht marrëveshjen për kufirin detar. Ishte "Gazeta Shqiptare", që zbuloi tekstin e kësaj marrëveshjeje dhe në bashkëpunim me kolonelin e njohur Myslim Pashaj u arrit të shpjeçohej e qartësohej fakti se Shqipëria me këtë pakt i dhuronte Greqisë mbi 300 km katrorë territor. Opozita e asaj kohe e dërgoi çështjen në Gjykatën Kushtetuese, e cila e në vendimin e saj përfundimtar votoi unanimitisht 9 me 0 për ta cilësuar nul këtë pakt. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, Nr. 15, datë 15 prill 2010, i cili gjykoj çështjen në themel, vëren se projekt-marrëveshja detare me Greqinë ishte në kundërshtim me Kushtetutën për shkak të (1) mospajisjes së delegacionit shqiptar me plotfuqi të rregullt nga Presidenti i Republikës për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e marrëveshjes, (2) mangësi serioze në përmbajtjen e marrëveshjes, (3) moszbatimin e parimeve bazë të së drejtës ndërkombëtare për ndarjen e hapësirave detare midis dy vendeve, me qëllim arritjen e një rezultati të drejtë dhe të ndershëm dhe (4) mosmarrjen parasysh të ishujve si rrethana të veçanta në delimitimin e hapësirave detare. Sipas ekspertëve të fushës, regjimi detar në Detin Egje është vendosur nga Fuqitë e Mëdha në vitin 1936, duke detyruar Greqinë, që gjerësinë e detit territorial të shpallur në vitin 1930 prej 10 milje detare, ta modifikojë në 6 milje detare. Por, pavarësisht kësaj, Greqia ruajti gjerësinë e hapësirës ajrore 10 milje detare. Greqia për shkak të pozicionit gjeografik mund të delimitojë detin e saj territorial vetëm me Turqinë dhe Shqipërinë. Në kushtet e presionit të fortë ndërkombëtar, duket se Greqia Marrëveshjen Detare me Shqipërinë të vitit 2009 synonte ta përdorte si precedent në të ardhmen.

Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias deklaroi dje, se në negociatat me Bushatin kanë rënë dakord që shtrirja territoriale të jetë deri në 12 milje. A mund të realizohet kjo?

Së pari, më duhet të theksoj se pala shqiptare nuk është transparente dhe kjo është për të ardhur keq. Të gjithë informacionin, në lidhje me bisedimet midis ministrave të Jashtëm, por dhe midis atyre të mbrojtjes, shqiptare dhe grek, i marrim vesh vetëm nga pala greke. Gjykoj që ata janë, o nën presion, o janë më demokratikë se ne, apo media e tyre dhe në përgjithësi opinioni zyrtar grek janë më të ndjeshëm se ne, për çështjen e detit. Edhe lajmin e fundit e morëm vesh nga media greke, nga Kotzias, i cili edhe pse shumë i kufizuar në deklarata u shpreh për sukses në bisedimet me palën shqiptare, duke thënë se ata njohën zgjerimin e ujërave territoriale greke në 12 milje. E parë thjeshtë, kjo deklaratë e Ministrisë Kotzias duket si një e drejtë e çdo vendi, të përcaktojë vetë me ligjin e kufirit, shtrirjen e Ujërave territoriale, mbështetur dhe në Konventën e Montego-Bay, e cila lejon këtë shtrirje deri në 12 milje detare. Por, po të kesh parasysh që Greqia me ligjin e saj të kufirit gjysh në vitin 1936, e deri më sot e ka detin terri-

FAKTET

"Pala shqiptare duhet të insistojë që marrëveshja e re që kërkohet të negociohet të ketë si bazë që Greqia, të ruajë 6 milshin si ujëra territoriale. Kujtojmë se po me 6 milje Greqia ka bërë marrëveshjen me Italinë, me të cilën edhe Shqipëria ka përfunduar marrëveshjen për ndarjen e detit në vitin 1993. Po 6 milje ia njeh edhe Turqia, edhe pse nuk ka bërë ende marrëveshje",-tha dje, eksperti.

Ministrisë së Mbrojtjes së RSH, në ndarjen e shelit territorial dhe zonës ekonomike me Italinë, të cilën e kemi përfunduar në janar të 1993, janë 4 vjet bisedime që i kam drejtuar. E kam të vështirë të flas sot, sesi janë planifikuar veprimet e mëtejshme, sepse duhet të njihem me metodologjinë që kanë përcaktuar dy ministrat për të rihapur negociatat.

Po nëse marrëveshja e parë e ka pasur të përcaktuar shtrirjen në 6 milje, përsëridiskutohet mbi këtë pikë? Pala shqiptare është e kushtëzuar nga Gjykata Kushtetuese që të rrijë në versionin nga e para. Gjykata Kushtetuese e ka shpallur nul marrëveshjen e parë. Kështu që mirë bëhet që bisedohet me Greqinë, por duhet të na e bëjnë transparente për çfarë parimesh kanë rënë dakord, në mënyrë që ekspertët t'i dinë këto parime dhe ta janë parime të mbështetura në Konventën Ndërkombëtare të Detit. Le të presim.

A jeni kontaktuar ju si ekspert para nisjes së negociatave?

Ata punojnë me dyer të mbyllura tërë kohën. Për mua qeveria e PS-së që pati nderin kur ishte në opozitë që e çoi në Kushtetuese deri tani ka 5 vjet që nuk na ka

thënë asgjë konkrete se ç'do bëhet me këtë marrëveshje të re.

Gjithçka duhet riparë nga fillimi. Gjykata Kushtetuese e ka thënë të formës së prerë. Në momentin që rrezohet fillon nga e para. Pala greke ka tentuar dhe më parë dhe ka thënë se Gjykata e ka hedhur poshtë vetëm për arsye procedurale dhe jo substanciale me qëllim që të ruhet marrëveshja e vjetër, në të cilën ishte e favorizuar.

Çfarë duhet pasur parasysh, veç miljeve në këtë rinegociim të dytë?

Unë i qëndroj gjykimit tim mbështetur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, që bën të pavlefshme këtë marrëveshje dhe tashmë duhet negociuar nga e para.

Pala shqiptare nuk duhet të përsërisë gabimet e bëra, sidomos ato që kanë qenë të dukshme dhe të vërtetuara tashmë nga grupi i ekspertëve, të cilët kanë gabuar rëndë, në mosmarrjen parasysh të eksperiencës së mëparshme në marrëveshjen me Italinë, në ngutjen për ta bërë sa më shpejt këtë marrëveshje dhe diku dhe për mungesë integriteti.

Marrëveshja e re që po projekttohet, pa dashur të bëj Kasandrën, pasi informacionet i kemi të pakta, duke pranuar si parim bazë në përlogaritjen e ujërave territoriale në 12 milje, do t'u shtroj ekspertëve tanë, një rrugë humbëse jo vetëm të hapësirës detare shqiptare, por dhe të integritetit të tyre, tashmë për herë të dytë dhe të pakorrigjueshëm. Nuk ka pabarazi më të madhe se të trajtohet në mënyrë të barabartë, të pabarabartë! Ky është dhe mesazhi im. Ju faleminderit!

KRIMINALITETI REZULTATI


Ambasadori i SHBA: Ju keni një shprehje "Dielli duket që në mëngjes"

"Peshqit e mëdhenj", Lu: Ne investuam, ku janë rezultatet?

"Duam, rezultate para pranverës. Tik-Tak"

Valentina Madani

SHBA-të kanë investuar burime për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, ndaj ambasadori amerikan në Tiranë dje shtroi pyetjen: Ku janë rezultatet? Lu u kërkon politikë, policëve dhe prokurorëve që të mbajnë zotimin e tyre para popullit shqiptar dhe SHBA-ve. Ambasadori amerikan, Donald Lu u ka dërguar një mesazh publik politikaneve, policëve dhe prokurorëve, të cilëve u rikujton zotimin përpara popullit shqiptar dhe partnerëve ndërkombëtarë për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Lu drejton pyetjen se ku janë rezultatet e zotimit që bënë politikanët shqiptarë, policët dhe prokurorët kur nisën operacionin "Forca e Ligjit", i asistuar nga BE dhe SHBA. Ambasadori amerikan megjithatë sqaron se ndërkombëtarët kërkojnë rezultate konkrete këtë pranverë. "Ne investuam në burimet për t'ju ndihmuar. Ku janë rezultatet?", pyet Lu në mesazhin e postuar në faqen në "Facebook" të Ambasadës Amerikane. Ai thekson se populli shqiptar do që t'i jepet fund pandëshkueshmërisë. "Komuniteti ndërkombëtar kërkon rezultate konkrete përpara vendimeve të rëndësishme këtë pranverë", nënvizon Donald Lu. Si për të theksuar kohën që po kalon, ambasadori mbyll reagimin e tij me të tik-takun e orës. Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu, pat paralajmëruar në vjeshtë të 2017-ës se në muajin janar 2018 do arriheshin "peshqit e mëdhenj". Mbetet për t'u parë nëse afati i radhës i vendosur nga ambasadori Donald Lu do zbatohet nga autoritetet shqiptare, politikanë, policë e prokurorë - për të vënë në jetë më në fund "Forcën e Ligjit", kjo e kombinuar edhe me zbatimin e reformës në drejtësi, me ngritjen e BKH, për të parë që më në fund pas hekurave ata që kanë dominuar botën e krimin dhe korrupsionit në Shqipëri përgjatë 27 viteve.



Ambasadori amerikan, Donald Lu

DEKLARATA

"Ne investuam në burimet për t'ju ndihmuar. Ku janë rezultatet?", pyet Lu në mesazhin e postuar në faqen në "Facebook" të ambasadës amerikane. Ai thekson se populli shqiptar do që t'i jepet fund pandëshkueshmërisë.

Posti i rëndësishëm i ofruar nga Rama?

Bregu: Aplikova për në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal

Ish-ministria e Integritimit, Majlinda Bregu sqaroi dje pozicionin e saj në lidhje me një aplikim që ajo ka bërë për sekretar të përgjithshëm të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal. Në një status në "FB", ajo shprehet se ka aplikuar vetë në këtë pozicion, duke hedhur poshtë të gjitha pretendimet se është propozuar nga qeveria shqiptare. "E para, po! Kam aplikuar me emrin tim për këtë pozicion. I cili është i pari i këtij niveli që nëse do ta fitoj, i jepet një shqiptari. E dyta! Nuk është pozicion që varet nga qeveria shqiptare dhe për rrjedhojë nuk mund të ofrohet nga qeveria shqiptare. Nota duhet të përcillet zyrtarisht nga Ministria e Jashtme, siç ndodh me çdo kandidat nga vendet e tjera që kanë aplikuar. Zgjedhja e sekretarit të përgjithshëm



Aplikimi

"Po! Kam aplikuar me emrin tim për këtë pozicion. Nuk është pozicion që varet nga qeveria shqiptare dhe për rrjedhojë nuk mund të ofrohet nga qeveria shqiptare", tha Bregu.

është një proces i gjatë përzgjedhjeje, votimesh në disa nivele nga të gjitha vendet e Evropës Juglindore dhe ku Komisioni Europian është partneri i tij kryesor. Sigurisht që nuk u kushton

asnjë lekë taksapaguesve shqiptarë. E fundit! Nëse do ta fitoj këtë pozicion, do të jetë një nder për mua, Shqipërinë dhe shqiptarët kudo në rajon", tha zj.Bregu.

tuar ndaj grupeve kriminale. Shqipëria ka një problem mes lidhjeve mes grupeve kriminale dhe politikaneve. Nëse e mohoni këtë, shqyrtoni rastet e Arben Ndokës, Arben Frrikut, Elvis Roshit dhe Gentian Mahmutajt. Në fillim të vitit të ardhshëm, në

gjuhën shqipe ju thonë 'peshku i vogël e ha të madhin', për njëherë të vetme në Shqipëri do të hamë 'peshkun e madh', pat deklaruar ambasadori Lu pak muaj më parë, gjatë një aktiviteti të Ministrisë së Brendshme në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit".



Gjatë një seance parlamentare

"TEKNOLOGJIA PRIORITET"

Bylykbashi: Ta harrojnë, nuk tërhiqemi nga votimi elektronik

PD-ja ka prioritet teknologjinë në zgjedhje dhe sipas Oerd Bylykbashit, PS-ja gënjën kur thotet se është hequr dorë nga reforma zgjedhore dhe përdorimi i teknologjisë në zgjedhje. Ndryshe për çfarë foli bashkëkryetari i Komisionit të Reformës Zgjedhore, Blendi Çuçi, demokrati Bylykbashi sqaroi se opozita nuk ka kërkuar kurrë votim 'online'. "Ajo që ne propozojmë është votimi elektronik, por që nuk është 'online'. Është e pamundur që piratët informatikë të ndërhyjnë për të ndryshuar rezultatit", deklaroi z.Bylykbashi. Deputeti demokrat u shpreh se PD i mbetet kësaj pike dhe do e koordinojë qëndrimin me të gjithë aleatet e saj dhe LSI-së. "PD e ka prioritet absolut teknologjinë në zgjedhje. Është instrumenti me i rëndësishëm, që do bënte transparencën e blerjes së votës. PS gënjën në këtë formë që kemi hequr dorë nga përdorimi i teknologjisë në zgjedhje, sepse kërkon të ruajë statusqounë për të përdorur kriminelët që të blejë zgjedhjet. PD nuk do e tolerojë heqjen nga prioriteti i votimit elektronik. Sistemi zgjedhor është në tryezën e komisionit, PD i mbetet kësaj pike dhe do e koordinojë qëndrimin me të gjithë aleatët e saj dhe LSI. Kjo kërkon konsensus edhe me krahun tjetër, por duhet trajtuar pasi t'i japim zgjidhje shittblerjes së zgjedhjeve, përpara të cilave dështon çdo sistem dhe do diskutohet. Edhe ndërkombëtarët po e mbështesin votimin elektronik mbi bazën e një pune serioze të ekspertëve ndërkombëtarë që të bëhet përpara zgjedhjeve. Ata thanë se votimi elektronik mund të sjellë ndryshime të dukshme. Pretendimi i PS se jemi tërhequr nga votimi 'online' s'është i vërtetë, ne kemi kërkuar votim elektronik. Votimi elektronik s'do jetë 'online', por do bëhet në qendrën e votimit, që procesi të ketë siguri", tha Bylykbashi. Ai njoftoi se javës tjetër do të miratohet kalendari dhe votimi elektronik është prioritet.



BLLOKIMI

"Jemi në fazën e fundit të planit të punës dhe kalendarit. Kemi përcaktuar që votimi elektronik është prioritet, çdo gjë e thënë nga PS për këtë gjë është gënjeshtrë. Javën që vjen të miratojmë kalendarin, më pas çdo pengesë është për të bllokuar reformën zgjedhore", - tha deputeti i PD.



Shteti shqiptar do t'i paguajë qiranë e banesës kryeprokurores së përkohshme Arta Marku. Vendimi është marrë në mbledhjen e sotme të qeverisë, e cila ka vendosur që zonjës Marku t'i jepet një shumë mujore prej 350 mijë lekësh të vjetra për të paguar qiranë. "Kompensimin, në masën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, të paguesës së qirasë së banesës për strehimin, në qytetin e Tiranës, të prokurorit të caktuar të kryejë përkohësisht detyrën dhe funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm. 2. Paga e kompensimit, deri në përfundim të periudhës së përkohshme, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të kryhet çdo muaj, me fondet e buxhetit të miratuar për vitin 2018 për Prokurorinë e Përgjithshme. 3. Shuma e

350 mijë lekë për qiranë, zbardhet vendimi i qeverisë

Qeveria i paguan qiranë e banesës së kryeprokurores Marku



Kryeprokuroerja Arta Marku

përgjithshme e fondit, që do të përdoret për pagesat e kompensimit, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe të rishpërndahet në buxhetin e miratuar për Prokurorinë e Përgjithshme", thuhet në vendimin e qeverisë. Vendimi i qeverisë hyn në fuqi menjëherë. Arta Marku ishte në prokurorinë e Shkodrës prej shumë vitesh ku edhe banonte. Në këtë mënyrë

qeveria merr përsipër përmes një VKM, që të paguajë qiranë e banesës së kryeprokurores së përgjithshme Arta Marku, e cila jeton me qira në një apartament në Tiranë.

DOREHEQJA

Anëtar i Gjykatës Kushtetuese Besnik Imeraj dha dje dorëheqjen për arsye personale. Imeraj u dekretua si anëtar i Gjykatës Kushtetuese nga presidenti i asaj kohe Bujar Nishani me dekret nr. 8066, datë 22 mars 2013.

PADIA E GASHIT

Gjykata Administrative mori dje në shqyrtim padinë e ish-drejtores së Marrëdhënieve me jashtë në Prokurori Rovena Gashi ndaj kryeprokurores Marku. Përfaqësuesja e Marku tha se motivi i largimit nga detyra ishte fakti që Gashi kishte dërguar në KQZ materiale pa marrë miratimin e titullares. Por avokati mbrojtës i Gashit z. Çlirim Gjata e cilësoi të paligjshëm veprimin e zonjës Marku, dhe për të marrë më shumë sqarime në lidhje me procedurën e ndjekur, kërkoi paraqitjen e saj në gjykatë.



Enkelejd Alibeaj: Financieri i drogës së Tahirit u ekstradua kur pranoi të bashkëpunonte

PD publikon procesverbalin për arrestimin e Seitajt

"Në interpelancë urgjente ministrja e Drejtësisë"

Valentina Madani

Partia Demokratike ho dhi dje poshtë preten dimet e ngritura nga Ministria e Drejtësisë lidhur me ekstradimin e të dyshuarit si financiar në bandën e Habilajve, Nezar Seitaj se nuk ka qenë në dijeni të faktit se ndaj tij kishin nisur hetimet në Shqipëri. PD disponon provën zyrtare që provon se, për t'i shërbyer Edi Ramës që të mbyllë dosjen "Tahiri", ministrja e Drejtësisë gënjen, kur deklaroi se nuk ka qenë në dijeni se financiar i bandës Tahiri-Habilaj po hotohej në Shqipëri. Sipas ligjit shqiptar, kur një person ka një procedim penal në Shqipëri, ekstradimi i tij është i ndaluar. Deputeti Enkelejd Alibeaj publikoi një procesverbal të mbajtur nga policia për arrestimin e Seitajt. Enkelejd Alibeaj: "Ky është procesverbal i mbajtur nga policia për arrestimin e Nazer Seitajt. Në procesverbalin e arrestimit të financierit të drogës së Tahirit dhe Habilajve, thuhet se Nazer Seitaj u ndalua për llogari të Prokurorisë së Krimeve të Rënda më 19 tetor 2017, pas aksionit në Babicë të Vlorës, ku u sekuestruan 4 tonë drogë. Ky procesverbal rrezon deklaratën e ministres së Drejtësisë se nuk e dinte që për Nezar Seitajn



Deputeti Enkelejd Alibeaj

MINISTRI ITALIAN Ministri italian i Drejtësisë, Andrea Orlando reagoi dje në lidhje me ekstradimin e "Financierit të Habilajve", Nazer Seitit, duke falënderuar autoritetet shqiptare për dorëzimin e tij të drejtësisë italiane.

kishte një çështje penale në Shqipëri. Procesverbalin e policisë tregon, gjithashtu, se financiar i bandës Tahiri-Habilaj është arrestuar më 19 dhe jo më 20 tetor, siç deklaroi ministri i Brendshëm, i cili vetë është pjesë kyçe e skemës së Ramës për ekstradimin e dëshmitarit të vetëm të arrestuar që mund të tregonte për të drogës së Saimir Tahirit. Sipas ligjit shqiptar, kur një person ka një procedim penal në Shqipëri, ekstradimi i tij është i

ndaluar". - theksoi z. Alibeaj. **INTERPELANCA** Partia Demokratike ka vendosur të thërrasë në një interpelancë urgjente ministrin e Drejtësisë, Etilda Gjonaj për ekstradimin e Nazer Seitit. Deputeti Enkelejd Alibeaj tha se Nazer Seitit u "rrembye" nga shteti ditën kur do tregonte gjithçka për Tahirin. "Nazer Seitit është rrembyer nga shteti shqiptar ditën kur pranoi të ishte bashkëpunëtor i Prokurorisë së Krimeve të Rënda për të

Ekstradimi i Seitit, KLD: Shkelje të rënda, nis hetimi për gjyqtarin

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kastriot Gramshi për lejimin e ekstradimitit të Nazer Seitit drejt Italisë në kuadër të hetimeve për dosjen 'Habilaj'. KLD njofton se nga shqyrtimi paraprak i ngjarjes, konstatohet se ka vend për fillimin e hetimit disiplinor për të verifikuar dyshimet e arsyeshme të ngritura në media dhe në opinionin publik për shkelje në procedurat gjyqësore të ekstradimitit dhe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. "Nga ankesa publike dysho-



het për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit sipas nenit 140 pika 2 të Kushtetutës (shkelje haptazi e nenit 491 pika 1 shkronja 'ç' dhe 498 pika 2 të

K.Pr.Penale), të cilat nëse provohen se janë kryer, veç të tjerave përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuara nga ligji. Në përfundim të hetimit disiplinor nga Inspektorati i KLD-së, publiku do të njihet me rezultatet e tij dhe do të ndiqen procedurat ligjore"-deklaroi KLD. Nazer Seitit u ekstradua pak ditë më parë drejt Italisë, ndërsa Prokuroria e Përgjithshme kërkoi hetim disiplinor të 4 prokurorëve. Arta Marku deklaroi se ekstradimi ishte me shkelje, ndërsa erdhi si pasojë e mungesës së komunikimit me Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe asaj të Tiranës.

rrefyer milionat e marra nga Saimir Tahiri si përfitim nga trafiku ndërkombëtar i drogës. Ky është një akt më i rëndësishëm trafikimi i drogës nga Saimir Tahiri. Përkëtë arsye PD ka vendosur të thërrasë në një interpelancë urgjente ministrin e Drejtësisë Etilda Gjonaj si përgjegjëse kryesore për ekstradimin e paligjshëm të Nezar

Seitit, financiar i bandës Habilaj-Tahiri", theksoi z. Enkelejd Alibeaj. Po dje, përmes një mesazhi në faqen e tij të Facebook'-ut, Berisha publikoi një dokument që sipas tij dëshmon se ministrja Gjonaj duhet arrestuar, pasi ka shkelur ligjin mbi procedurën e ekstradimitit të Seitit. "Nëpërmjet zëdhënësës së tij Etilda, e cila firmosi me

urgjencë largimin nga Shqipëria të financierit të bandës Tahiri -Habilaj, pasi u mor vesh se kryeprokurori Rama nuk kishte pyetur njëri, ai mashtroi përsëri qytetarët duke gënjyer pa u skuqur dhe pa u zverdhur se e ekstradoi Nazer Seitit", shkruan Berisha, bazuar tek dhënia e një punonjësi dixhital nga Ministria e Drejtësisë.

Qeveria vendos përcaktimin e grupeve të favorizuara për punësim në ndërmarrjet sociale

Qeveria përcakton kategoritë e personave që do të kenë përparësi për t'u punësuar në ndërmarrjet sociale. Me një vendim të posaçëm janë përcaktuar 27 kategoritë përfituese ku janë përfshirë personat me aftësi të kufizuara, ish-të dënuarit, të papunët për një periudhë afatgjatë prej të paktën 12 muajsh etj. Sipas vendimit ndërmarrjet sociale kontribuojnë në mbrojtjen sociale dhe mbështetjen e personave e të grupeve të pa favorizuara nëpërmjet punësimit dhe lehtësimit të aksesit në tregun e punës.

GRUPET

Grupet e personave të pa favorizuar kategorizohen në persona në kushte të pafavorshme janë përfituesit e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar në moshë aktive pune dhe persona që nuk kanë ndjekur arsimin e detyrueshëm, të cilët janë të rrezikuar të përjashtohen nga tregu i punës dhe përballen me shumë vështirësi për sigurimin e një pune të qëndrueshme dhe që siguron të ardhura ose përfitime të mjaftueshme. Përfitues janë të vetpunësuarit ose punëtorët e fermave familjare në bujqësi, të cilët janë të ekspozuar ndaj një pune të pasigurt e të paqëndrueshme, të cilët, në rast të dështimit të punës individuale apo në familje, rrezikohen të përballen me vështirësi të shumta në integrimin e tyre në tregun e punës. Në listën e personave që do të punësohen në ndërmarrjet sociale qeveria ka përfshirë personat që jetojnë në zonat rurale që nuk kanë tokë, të cilët ndeshen

Punësimi social, përfitojnë 27 kategori shtresash në nevojë

Në listë, personat me aftësi të kufizuara, ish-të dënuarit



Gjat një mbledhjeje të qeverisë

me vështirësi të shumta në sigurimin e mjeteve të jetesës në mungesë të tokës dhe të aktivitetit bujqësor, pasi mundësitë që ofron tregu i punës për këto kategori janë shumë të kufizuara dhe të papunët për një periudhë afatgjatë prej të paktën 12 muajsh. Do të përfshihen në program: personat deri në 24 vjeç ose personat që kanë mbaruar stu-

dimet e arsimit të lartë prej jo më shumë se dy vjetësh dhe nuk kanë filluar një punë; punonjësit migrantë që zhvendosen ose janë zhvendosur brenda vendit; personat që u përkasin pakicave kombëtare, të cilët kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën amtare dhe të përmirësojnë formimin e tyre profesional apo përvijën në punë, në mënyrë që

të rrisin mundësitë për një punësim të qëndrueshëm; çdo kryefamiljar që jeton vetëm ose është beqar, që ka në ngarkim të paktën një fëmijë; persona që i përkasin moshës mbi 50 vjeç; çdo person që nuk ka përfutur një diplomë të arsimit të mesëm apo një diplomë ekuivalente më të, ose ka dy vjet, pas përfundimit të studimeve të arsimit të mesëm me kohë të

KUSHTET

Grupet e personave të pa favorizuar kategorizohen në persona në kushte të pafavorshme janë përfituesit e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar në moshë aktive pune dhe persona që nuk kanë ndjekur arsimin e detyrueshëm, të cilët janë të rrezikuar të përjashtohen nga tregu i punës dhe përballen me shumë vështirësi për sigurimin e një pune të qëndrueshme dhe që siguron të ardhura ose përfitime të mjaftueshme.

ie, me dënim alternativ apo çdo lloj dënimi tjetër penal. **PUNËSIMI PËR GRATË**

Në zonat rurale do të kenë përparësi gratë dhe bëhet fjalë për zonat ku niveli mesatar i papunësisë e kalon 50% të nivelit mesatar kombëtar për të paktën dy vjet kalendarikë dhe ku papunësia e gjinisë femërore është mbi 150% e nivelit mesatar të papunësisë së gjinisë mashkullore për të paktën dy nga tre vjetët e fundit kalendarikë. Sipas vendimit përfitues janë edhe gratë dhe vajzat viktime të mundshme të trafikimit, të shfrytëzimit dhe të dhunës në familje dhe personat me aftësi të kufizuara. Përfitojnë përparësi për punësim refugjatët, sipas përcaktimit të ligjit për azilin, azilkerkuesit, personat me mbrojtje plotësuese, personat me mbrojtje të përkohshme, anëtarët e familjes së refugjatit, anëtarët e familjes së personit që i është njohur statusi i mbrojtjes plotësuese, personat pa shtetësi, personat e pastrehë, ish-të burgosurit dhe personat me identitet të ndryshëm gjinor dhe orientim të ndryshëm seksual.

plotë, që nuk ka një punë me pagesë të rregullt apo rrezeikon ta humbasë atë. Sipas vendimit në këtë program do të përfshihen edhe personat që rezultojnë të varur apo ish-të varur nga droga, alkooli apo substanca të tjera psikotrope dhe personat, të cilët nuk kanë pasur punën e tyre të parë të paguar rregullisht që nga fillimi i vuajtjes së dënimit me heqje lir-

Plani i masave 2017-2021

Tatimet hartojnë planin operacional, prioritet mbledhja e borxhit

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve zhvilloi të martën, mbledhjen e radhës së Komitetit Operacional me objekt "Miratimin e planeve operative të vitit 2018". Planet operative janë mbështetur në strategjinë afatgjatë 2017-2021. Në qendër të këtyre planeve, për vitin 2018 do të jetë garantimi i asistencës për përmbytjen vullnetare, zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, si dhe progresi organizativ i administratës tatimore e rritja e kapaciteteve të saj. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ndërvëprimet të brendshëm institucional, ku drejtoritë do të përfshihen në veprim të përbashkët sipas afateve të mirëpërcaktuara në drejtim evidencimit të sektorëve me risk, përfshirjen e tyre në plane sektoriale të përmbytjes vullnetare, kontrolleve me qëllim korrigjimin e sjelljes deviante të tatimpaguesve. Më tej, sa i përket mbledhjes së detyrimeve tatimore në planin operacional të këtij viti, është përcaktuar qartë filozofia e prioritarizimit të borxhit tatimor, ndjekjes dhe arkitimit të tij si dhe forcim i bashkëpunimit me qendrën e thirrjeve për informimin në kohë të tatimpaguesve për të parandaluar krijimin e detyrimeve të reja. Një tjetër çështje, e cila do të jetë në fokusin e administratës lidhet me forcimin e kapaciteteve dhe burimeve njëzore, të cilët do të përfshihen në programe trajnimesh të vazhdueshme e do të vlerësohen sipas kritereve të qarta të matjes së performancës.

Inspekton punimet e Ujësjellës - kanalizimeve

Gjijknuri: Një nga veprat transformuese për të gjithë qytetarët e Durrësit



Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë Damian Gjijknuri

nikimi që kam pasur me kryetarin e Bashkisë, puna sidomos vitin e fundit po ecën shumë mirë. Shpresojmë që të mbyllet në kohë dhe është një nga veprat transformuese për të gjithë qytetarët e Durrësit", -u shpreh ministri Gjijknuri. Ndërkohë, kryebashkiaku i Durrësit shtoi se me këtë investim mbyllet përfun-

dimisht edhe problemi me derdhjen e ujërave të zeza. "Këto dy investime, së bashku me rehabilitimin e rrjetit të brendshëm të ujësjellës dhe furnizimit me ujë të të gjithë qytetit të Durrësit, besojmë se në qershor të vitit 2019 ne do kemi zgjidhur përfundimisht ujësjellësin e furnizimin me ujë, ujërat e zeza dhe

ujërat e bardha", - nënvizoi Dako. Ndërkaq, Gjijknuri iu bëri thirrje edhe familjarëve që të ndjekin afatin e përcaktuar për të formalizuar lidhjet e ujit të pijshëm në mënyrë që të shmangin penalitetet. "Të gjithë këto investime që të jenë të qëndrueshme duhet të kemi një shëndoshje financiare të sektorit. Shëndoshja financiare vjen nga pagesa e rregullt e ujit ashtu sikurse ndodhi me energjinë. Qytetarët që paguanë nuk mund të mbajnë përsipër edhe ata që nuk paguanë. Nëse të gjithë paguanë, kemi mundësinë të bëjmë edhe më shumë investime", - u shpreh Gjijknuri. Dako tha se aksioni për prerjet e lidhjeve të paligjshme të ujit në qytetin e Durrësit ka nisur. Ai shtoi më tej se kanë filluar ju vetëm lidhjet e reja, por edhe pagesat pranë sporteleve, të cilat sipas tij janë shumëfishuar.

Dëmi ekonomik i shkakuar nga shkeljet dhe abuzimet me detyrën të kreut të Bashkisë së Kukësit arrin në 59 milionë lekë. Shpenzimejo në përputhje me administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, efektivitet dhe eficientë në vlerën 65 milionë lekë, sipas auditit të realizuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Më konkretisht shkeljet janë konstatuar në shërbimi mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve, rikonstruksion i qendrës sociale-Kukës, mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora, mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural të Bashkisë Kukës si dhe një sërë shkeljesh që kryesisht

Abuzime në Bashkinë e Kukësit, dëmi 124 mln lekë

KLSH kallëzon penalisht kryetarin, Bashkim Shehu

kanë të bëjnë me mirëmbajtje të rrugës. Në lidhje me shkeljet e sipërcituara, KLSH ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, kallëzimin penal ndaj kryetarit të Bashkisë Kukës dhe titullarit të Autoritetit Kontraktor me akuzën e konsumimit të veprës penale të "Shpërdorim i të detyrës". KLSH, me qëllim përmirësimin e situatës, i ka rekomanduar

Bashkisë Kukës masa me karakter organizativ në lidhje me eliminimin e praktikave që kanë sjellë impakt negativ në buxhetin e institucionit, kryesisht në administrimin e tatimeve dhe taksave, në vlerën 32 milionë lekë. Nga auditimi u konstatuan një sërë shkeljesh dhe parregullsish në zbatimin e dispozitave përkatëse ligjore e nënligjore në fushën e prokurimeve,

sidomos përsa i përket përzgjedhjes së procedurave të prokurimit; përlogaritjes së sasisë së punimeve; hartimit të kriterëve për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit; vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë konkurrues; si dhe mosrespektim dhe moszbatim të kushteve të kontratës së nënshkruar midis palëve. Më konkretisht, nga auditimi i të të pro-



cedurave të prokurimit: Shërbimi mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve, rikonstruksion i qendrës sociale-Kukës, mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora, mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural të Bashkisë Kukës, sistemim i qendrës së fshatit Orgjest, rikonstruk-

sion i rrugës Myç-Mëmëz-Vend depozitimi i mbetjeve + ndërtimi i rrethimit të jashtëm të vend depozitimit -viti 2016, mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural të Bashkisë Kukës, mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora, kanë rezultuar shkeljet si më poshtë:

Procedura do të realizohet online në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme

Ornela Manjani

Dogana, Ahmetaj: Sipërmarrja jo më kontakt me punonjësit

Mallrat ndahen në kanale sipas riskut

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, ka lajmëruar për lehtësimin e mëtejshëm të procedurave për sipërmarrjen, kësaj rradhe në fushën e doganave. Procedura e vlerësimit në doganë tashmë do të jetë tërësisht online, pas 27 vitesh. Në këtë mënyrë sipërmarrja nuk do të ketë më kontakt të drejtpërdrejtë me punonjësit e doganës në terren që kryejnë këtë proces. Vlerësimi do të realizohet në një qendër të dedikuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Sektorit të Vlerës në Qendër. Puna e këtij sektori është e përcaktuar në procedurat standarde të miratuara së fundmi dhe do të jetë e organizuar në kanale sipas nivelit të riskut. Klasifikimi i deklaratave doganore në kanalin blu, nënkupton se ato nuk do të nënshtrohen kontrolleve në terminale. E gjithë procedura e vlerësimit do të jetë tërësisht online dhe transparente, duke garantuar kështu një trajtim të operatorëve në mënyrë të barabartë. Për çdo paqartësi do të mundësohet komunikimi elektronik, i cili eliminon kështu vonesat dhe keqinterpretimet dhe vlerësimi do të jetë i shoqëruar nga një raport elektronik të faktuar mes Drejtorisë së Doganave dhe Agjencive Doganore. Në këtë mënyrë arrihet një ekuilibër më i drejtë nëpërmjet kontrolleve, reduktohet korrupsioni dhe lehtësohet tregtia duke shkurrtuar kohën e zhdoganimit të mallrave. Në takim ishte edhe kryeministri Edi Rama, i cili u njoh me mënyrën e funksionimit të sistemit të ri digital. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave Belinda Ikononi shpjegoi se ngritja e këtij sistemi modern shfaq praninë fizike të doganierëve dhe kontaktin e tyre me sipërmarrësit, duke ulur ndjeshëm mundësinë për korrupsion



Kryeministri Edi Rama dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

VENDIMI

Tarifat e reja për zhdoganimin e automjeteve janë caktuar pak ditë më parë përmes një udhëzimi. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj ka përcaktuar metodologjinë për vlerësimin doganor dhe çmimet minimale për të gjithë automjetet që vijnë nga importi. Në udhëzim përcaktohet se për autoveturat çmimi minimal llogaritet sipas

Tarifat e reja për zhdoganimin e makinave

kubikëve dhe për furgonët dhe kamionët sipas peshës. Kështu për një autoveturë deri në 1400 cc çmimi i referencës nuk mund të jetë më pak se 130.000 lekë, për autoveturat mbi 1400-1900 cc, jo më pak se 200.000 lekë, për ato mbi 1900-2500 cc, jo më pak se 325.000 lekë dhe për


mjetet mbi 4500 cc jo më pak se 800.000 lekë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka publikuar një udhëzim të ri mbi mënyrën se si do të vlerësohen mallrat për qëllime doganore. Ndër të tjera, sqarohet edhe si do të bëhet vlerësimi për zhdoganimin e automjeteve.

dhe eliminimin e dokumentacionit në letër: "Kjo zyrë do të kryejë të gjithë vlerësimet doganore në sistem. Deri më sot, agjentët komunikonin direkt me punonjësit doganorë dhe dorëzonin të gjithë dokumentacionin në letër. Në momentin që ne sigurojmë deklarin online,

do të thotë që automatikisht doganierët do të kenë mundësi të shikojnë çdo gjë në sistem dhe do të bëjnë vlerësimin doganor." Për kryeministrin Rama, ajo cka dogana ofron tani është një përmbysje historike e së kaluarës, një transformim rrënjësor, i cili duhet të jetë i

paktheshëm. "Ajo që duhet bërë me vendosmëri, për ta futur sistemin tërësisht në punë, është e njëjta gjë si me të gjithë sistemit online. Për shkak të investimeve dhe të vëmendjes së madhe që i kemi kushtuar, qindra shërbime online, por shfrytëzimi i tyre është ende shumë i ulët,

jo vetëm për shkak të mungesës së njohjes dhe të informacionit, por edhe për shkak të alternativës. Që do të thotë se preferohet rruga tradicionale e kjo ka ndodhur edhe me vende që e kanë bërë këtë revolucion shumë kohë përpara dhe që sot janë vende lider në botë, si Estonia etj. Në rastin konkret duhet dhënë një mesazh shumë i qartë; nuk ka rrugë tjetër. Rruga tradicionale nuk do të lejohet më. Ndërkohë që nuk do të ketë më një histori dashurie dhe mëkatesh midis importuesve, eksportuesve dhe doganierëve, sepse doganierët do të jenë në trurin e sistemit, duke funksionuar siç funksionojnë këtu, në të gjithë sistemin dhe duke e ndjekur të gjithë procesin si një sy që vëzhgon dhe jo si një dorë që jep e merr. Paktheshmëria e kësaj pune duhet të jetë shumë e qartë për të gjithë. Bizneset duhet ta kenë të qartë, që një afat shumë i shkurtër është afati fundor. Kjo është përmbysje historike, sepse heq një barë shumë të madhe nga pikëpamja e burokracisë, nga pikëpamja e kohës, stresit dhe gjithë asaj që ka qenë një torturë për shumë vite. Për doganierët është kalimi në një nivel tjetër pune. E sigurisht, doganierët në këtë sistem të ri do të bëjnë një punë shumë më të qetë nga pikëpamja e stresit, por dhe shumë më të kualifikuar dhe për sa i përket korrupsionit dhe pengesat. Është një çlirim i madh, është një transformim shumë rrënjësor-tha Rama.



Kopac: Të ndahet OSHEE, të respektohen afatet ligjore

Sektori i energjisë vazhdon të trashëgojë problematika që në jo pak raste janë evidentuar nga institucione ndërkombëtare. Komisioni i Veprimtarive Prodhuese u njoh me raportin vjetor të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për vitin 2017, ku drejtori ekzekutiv i Sekretariatit, Janez Kopac, tërhoqi vëmendjen e autoriteteve shqiptare marrjen e masave për ndarjen e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Një tjetër çështje e ngritur në raport ishte edhe çmimi i energjisë për shumicën e konsumatorëve. Sipas tij, nuk janë ende të rregulluara dhe liberalizimi duhet të niste që më 1 korrik 2015. Si prioritet, zyrtari i EITI-t rekomandoi nevojën për të zhvilluar legjislacionin dhe sidomos zbatimin e tij në afate. Por, Kopac u shpreh se duhet përsheptim i procesit të miratimit të amendamenteve për Bursën e Energjisë, vonesë e cila ka ardhur si pasojë e zgjedhjeve të përgjithshme elektorale të mbajtura në qershor të 2017-s. Një çështje tjetër më rëndësi ishte dhe ajo e interkonjeksionit me Kosovën, për të cilën Kopac tha, se tashmë është përcaktuar një ndërmjetës nga qeveria gjermane për të "rakorduar" procesin mes palës kosovare dhe asaj serbe.

VRASJA NE TIRANE HETIMET

Viktima ndiqej prej 1 jave nga vrasësi. Gjendet motori me të cilin u larguan autorët e atentatit

Vrasja e Kasmit, në pranga miku i tij, Mario Meshini

Avokati: Nuk iu fsheh ngjarjes, arrestimi i tij është i paligjshëm

Ina Allkanjari

Pas shpalljes në kërkim të Domart Konjari si autor i vrasjes së Devi Kasmit, policia e Tiranës ka vënë në pranga ditën e martë Mario Meshinin, nën akuzën e bashkëpunëtorit. Sipas policisë, 25-vjeçarit dyshohet se ka nxjerrë në pritë viktimën dhe ka ndihmuar autorët të largohen nga vendi i ngjarjes. Shkak për këto dyshime janë bërë pamjet filmike nga kamerat e sekuestruara në vendin ku ndodhi atentati dhe mesazhi që Meshini i ka dërguar viktimës pak para se të qëllohej nga autorët. Por këto akuzat janë mohuar nga avokati mbrojtës i 25-vjeçarit, Ferdinand Ndoja. Ai pranon se Meshini i bëri SMS për t'u takuar, por klienti i tij dhe Kasmi ishin miq. Ndoja shprehet se Meshini ka parë të gjithë ngjarjen dhe momentin që Kasmi është ekzekutuar, por nuk ka asnjë lidhje. Më tej avokati thekson se kur Meshini ka shkruar ta takojë viktimën, ka qenë pa kaskë, që do të thotë se nuk kishte pse të fshehej. Sipas tij, arrestimi ka qenë i paligjshëm. "Nuk ka qenë i maskuar në momentin e vrasjes. Ai ka drejtuar motorin pa kaskë, që do të thotë ka qenë i hapur dhe



Viktima Devi Kasmi

nuk e dinte që do ndodhte një gjë e tillë, aq më shumë që e kishte shok. Shkoi ta takonte Dëfrimin. Po ta nxirrte në pritë viktimën, s'do ndodhej aty të ekspozohej. Sikur të bashkëpunonte.

Duket autori nga kamerat e sigurisë, duket personi që ka shtënë, duket edhe ky që ka qenë ngjitur me viktimën. Më pas ka shkruar në banesë, ka qenë i tronditur. Arrestimi nuk është për të



Mario Meshini


grumbulluar prova, por e kundërta. Meshini është me arsim të lartë, me biznes, ka biznes familjar, është në gjendje të mirë ekonomike. Meshini ka thënë se e nje viktimën dhe rrinte në pal-

estrën e tij. Ai ka thënë që viktima ka pasur probleme me të tjerë, ka shpjeguar çdo gjë me ndershmëri. Ata ishin miq, familjarët e tij kanë qenë në varrim dje", deklaroi avokati.

HETIMI

Mario Meshini, i arrestuar dy ditë më parë si bashkëpunëtor i autorëve të vrasjes së Devi Kasmit akuzohet për veprat penale "Vrasje me paramendim" dhe "Mbajtje pa leje të armëve luftarake". Ndërkohë, hetimet për ngjarjen vijojnë dhe pritet që dëshmia e 25-vjeçarit të japë të dhëna të plota për atentatin dhe autorët. Gjithashtu, burime nga blutë e Tiranës konfirmojnë se është gjetur edhe motori me të cilin u larguan autorët pas vrasjes së Devi Kasmit. Motori i sekuestruar është i njëjtë me atë që duket nga kamerat e sigurisë. Policia vijon operacionin për arrestimin e autorit, i cili dyshohet se është Domart Konjari. Viktima kishte pak kohë që ishte kthyer nga Spanja, arsye e kthimit në Shqipëri mendohet të ketë qenë një problem shëndetësor i vajzës së tij. Sakaq, gjatë qëndrimit në Spanjë mësohet se Kasmi ka tentuar të vrasë Domart Konjarin, pas përplasjes për pazaret dhe zonat e tregimit të kokainës. Kjo është pista kryesore e policisë për të zbardhur ngjarjen. Sipas burimeve nga policia, vrasësit ishin në ndjekje të Devi Kasmit për të paktën një javë. Ata janë kapur nga kamerat e sigurisë pranë palestrës që viktima kishte në zotërim, teksa gjurmonin lëvizjet e tij.

SKEMA E DROGËS



Për autoritet e drejtësisë franceze nuk ka asnjë dyshim që Domart Konjari është njeriu që ka drejtuar grupin e trafikut të kokainës nga Franca, Itali, Belgjikë dhe Holandë. Francezët nëpërmjet një letërporsie i thonë palës shqiptare se me gjithë kërkimet e kryera, Konjari nuk është gjetur në territorin Francës. Në botimin e dosjes franceze tregohen përgjimet e anëtarëve të grupit të kokainës, rrezikshmëria e Konjarit dhe pastrimi i parave e deri çmimi i page-

save të korrierëve. I pandehuri Domart Konjari paraqitet si personazhi qendror i rrjetit të trafikimit ndërkombëtar të kokainës, i përfshirë drejtpërdrejt në shumë operacione importimi të sasive të mëdha kokaine, në lidhje të drejtpërdrejta me Fatmir Hajdinin dhe trafikantë të shumtë rajonalë. Domart Konjari nuk është bërë e mundur të lokalizohet dhe arrestohet gjatë kohës së shqyrtimit të dosjes nga autoritetet gjyqësore të Francës.

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- 1- Apartament** me nr.5/131+1-20, Zk.8532, vol.12, fq.60, me sip.98 m2 e ndodhur në Lgji."Konferenca e Pezës", Sh.1, K.3, Ap.20, Fier. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 3,920,000 (tre milion e nëntëqind e njëzetë mijë) Lekë.
- 2- Njësi** me nr.4/122+1-N, Zk.8533, vol.11, fq.188, me sip.40 m2 e ndodhur në Lgji."15 Tetor", P.25, Sh.11, K.1, Ap.N, Fier. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 4,000,000 (katër milion) Lekë.
- 3- Truall** me nr.52/34, Zk.3981, vol.9, fq.192 me sip.3020 m2 e ndodhur në Sheq, Fier. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi** 4,800,000 (katër milion e tetëqind mijë) Lekë.
- 4- Truall + ndërtesë** me nr.52/44, vol.12, fq.132, Zk.3981, me sip.truallit 6134 m2 dhe me sip.ndërtesë 2160.2 m2 e ndodhur në Fshatin Sheq i Madh, Fier. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 59,440,000 (pesëdhjetë e nëntë milion e katërqind e dyzetë mijë) Lekë.
- 5- Godinë** me nr.3/166, vol.11, fq.242, me sip.totale 290.6 m2, Zk.8534 me vendodhje në Rr."Apollon", Fier. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 51,064,000 (pesëdhjetë e një milion e gjashtëdhjetë e katër) Lekë.
- 6- Truall** me nr.108/35, Zk.1791, vol.10, fq.248, me sip.500 m2 e ndodhur në Golem, Kavajë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 2,720,000 (dy milion e shtatëqind e njëzetë mijë) Lekë.
- 7- Truall** me nr.108/36, Zk.1791, vol.10, fq.249, me sip.2000 m2 e ndodhur në Golem, Kavajë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është** 10,400,000 (djetë milion e katërqind mijë) Lekë.

Ankandi për shitjen e të gjitha pasurive të sipërcituara do të zhvillohet ne date 13.02.2018, ora 16.00 ne seline e shoqerise EPSA SHPK ne adresen Rr "Ismail Qemali", Pall Fratari, K.6, Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

VITI MBAREKOMBËTAR I GJERË KASHTRIJTË SKENJËTITUR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
Këshilli Drejtues

NJOFTIM

Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë shpall vakand një vend, **Pedagog i Brendshëm në Shkollën e Magjistraturës.**

Kandidatët aplikant duhet të paraqesin pranë sekretarisë së Shkollës së Magjistraturës, kërkesën e tyre dhe dokumentat bashkëngjitur, brenda datës **23.02.2018.**

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve fitues janë përcaktuar në nenin 264, të Ligjit nr. 115/2016 «Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë», si dhe në aneksin 11 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës:

Ligji parashikon se pedagogët e brendshëm zgjidhen nga radhët e juristëve më të shquar;

- me eksperiencë mbi 15-vjeçare si juristë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe
- me eksperiencë mësimdhënëse si pedagogë të brendshëm në sistemin universitar ose si pedagogë të jashtëm e të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, me eksperiencë mbi 10 vjet.

Kandidati aplikant preferohet të jetë profesionist i spikatur në fushën penale.

Cdo aplikant duhet të marrë nga sekretaria e Shkollës, numrin e regjistrimit në protokoll të kërkesës për aplikim.

KËSHILLI DREJTUES I SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Kryeinspektori: Gjithçka e qëllimshme, më bënë presion që të jap dorëheqjen

Dëmtohen 197 ha pyje, procedohet penalisht kreu i ISHMP-së Beratit

Altin Kazazi akuzohet për shpërdorim detyre

BERAT

Altin Kazazi, kreu i ISHMP Berat është kallëzuar penalisht nga Ministria e Mjedisit, pasi akuzohet për shpërdorim detyre. Vendimi është marrë pas një inspektimi të hollësishtë në terren, ku janë konstatuar nga afër shkeljet ligjore si dhe pas verifikimit të dokumentacionit. Grupi i punës ka konstatuar se mosveprimet e të akuzuarit kanë sjellë një dëm të konsiderueshëm në një sipërfaqe prej 197 ha në fondin pyjor. Nga inspektimi rezultoi se nuk është bërë vlerësimi i subjekteve që ushtrojnë aktivitet brenda koordinatave të miratuara në lejet minierare, leje mjedisore dhe se nga kryeinspektori i Beratit nuk është bërë asnjë masë më denim për kundrvajtje administrative apo verifikim



Ministria e Mjedisit

dhe inspektim të subjekteve që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të qarkut Berat. Në letrën drejtuar Prokurorisë së Tiranës, kryeinspektori i komanduar i ISHMP-së dhe njëherësh sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Plarent Ndreca argumenton shkeljet e njëpasnjëshme që janë vënë re gjatë ushtrimit të detyrës nga ana e Kazazit, në pozicio-

nin e kryeinspektori rajonal të Beratit. "Të vendosur në tolerancën zero ndaj personave përgjegjës përgjatë ushtrimit të detyrës së tyre, veçanërisht kur këta të fundit mbajnë mbi supë përgjegjësinë e përbashkët të detyrës, ISHMPU e çmon si të domosdoshëm denoncimin pranë organeve përkatëse të ndjekjes penale. Duke qenë të bindur në luftën ndaj këtyre

fenomeneve në çmujmëse veprime të tilla dëmtojnë rëndë marrëdhëniet juridike të vendosura për mbrojtjen dhe mirëfunksionimin e shtetit ligjor të Republikës së Shqipërisë", shkruhet në letrën drejtuar prokurorisë. Krahas kallëzimit penal, grupi i inspektimit ka pezulluar edhe punimet e të gjitha subjekteve të inspektuara, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në fondin pyjor e kulloror në fushën e shfrytëzimit të minieraleve dhe gurëve gëlqerorë deri në plotësimin e plotë të dokumentacionit ligjor. Pas denoncimit në prokurori, Altin Kazazi deklaroi se gjithçka është e qëllimshme, pas presioneve që i janë bërë për të dhënë dorëheqjen. Ai ka mohuar kategorikisht akuzën për abuzim me detyrën, ndërsa tha se është një skemë pistë për ta shkarkuar nga funksioni.



Gjyqi ndaj atentatorit të Çapjave, policia "blindon" gjykatën

ELBASAN - Forca të shumta policore blinduan mesditën e djeshme Gjykatën e Elbasanit, teksa zhvillohej seanca paraprake në ngarkim të 20-veçarit Shkëlzen Hasanapa, i dyshuar si vrasës me pagësi i bandës rivale të Çapjave në Elbasan. Mësohet se në nisje të seancës, uniformat blu kanë shtuar sigurinë, duke shtuar sigurinë në të gjitha akset përreth gjykatës dhe Prokurorisë së Elbasanit. Policia ka ushtruar kontrolle të rrepta në të gjithë zonën ku ndodhen institucionet e drejtësisë në Elbasan para fillimit të seancës. Shkëlzen Hasanapa akuzohet si autor i atentatit të 6 qershorit të vitit 2016. Ai qëllon disa herë të botës së kimit në Elbasan. Breshëritë e automatikut që tronditën qendrën e këtij qyteti dhe lanë një vendngjarje me dy të plagosur, mu përpara derës së prokurorisë së rrethit, janë sfumuar dhe se dosja hetimore që nisi me shumë vrull nga akuzat për veprën penale të "Vrasjes në rrethana cilësuese" mbetur në tentativë ndaj Çapjas dhe Muçës është pushuar ndaj të riut Hasanapa. Tashmë nga prokuroria janë ngritur akuzat më të lehta dhe konkretisht: "Kanosjes me armë", "Armëmbajtje pa leje" si dhe ajo "Plagosjes së lehtë me dashje" në dëm të Bledar Muçës dhe efektives së policisë, Matilda Kërmezi. 20-veçarit Hasanapa u identifikua si autor i dyshuar i ngjarjes së dy viteve më parë pas krahasimit të ADN-së që u mor prindërve të tij. Ai u arrestua në Holandë dhe më vonë u ekstradua drejt Shqipërisë.

SHPLLJE PER LEVIZJE PARALELE NGRITJE NË DETYRE NË KATEGORINË E MESME DHE E ULËT DREJTUESE

Përgjegjës i Sektorit të Formimit Vazhdues: Lloji i diplomës "Shkenca Juridike". Niveli minimal i diplomës "Master Shkencor"

Në zbatim të neni 26, të ligjit 152/2013 "Për nepunësin civil" i ndryshuar, si dhe të Kruar II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Mjedisit, Shkolla e Magjistraturës shpall procedurën e levizjes paralele dhe të ngjritjes në detyrë për pozicionin:

1. Përgjegjës i Sektorit të Formimit Vazhdues - Kategoria: III-a

Pozicioni me sipër, i ofrimit fillimisht nepunësin civil të se njëjtes kategori për procedurën e levizjes paralele listën në rast se në përputhje të procedurës së levizjes paralele, rezultati se ky pozicion është ende vakant, ai është vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngjritjes në detyrë.

PER TE DY PROCEDURAT (LEVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRE) APLIKOHET NË TË NJEJTIN KOHË!

09/02/2018
Atlet për dorëzimin e dokumentave për: **LEVIZJE PARALELE**

14/02/2018
Atlet për dorëzimin e dokumentave për: **NGRITJE NË DETYRE**

Pershkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Formulimi, vlerësimi, kishillimi, analiza, kerkimi dhe zgjidhje e problemeve dhe çështjeve objektive i fushës së veprimtarisë së Sektorit të Formimit Vazhdues;
- Trajtimi në kohë dhe në mënyrë profesionale i çështjeve, problematike dhe reformave në fushat objektive të veprimtarisë së Sektorit të Formimit Vazhdues, organizimi, përfaqësimi, ndëgjyrimi dhe realizimi i politikave dhe veprimtarive që lidhen me fushën e Formimit Vazhdues;
- Sigurimi në kohë dhe në mënyrë profesionale i kishillimit dhe mbështetjes në formulimin dhe zbatimin e politikës së institucionit për pedagogji përgjegjësit të Formimit Vazhdues, kishillimit akademik dhe Drejtorit e Shkolles;
- Trajtimi dhe zbatim i politikës të jetës me koordinatim dhe veprimtari e tij të jetë efektive dhe efektive nga pikëpamje ekonomike dhe e shërbimeve të ofrimit; ndjekjen dhe marrjen e masave për kerkimin, perpunimin, ngritjen, dorëzimin dhe shkëmbimin e informacionit brenda dhe jashtë institucionit.

1. LEVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nepunësin civil të se njëjtes kategori, në të gjitha instancat gjyqësore dhe shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LEVIZJE PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidat duhet të plotësojë kushtet për levizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nepunësin civil të konfirmuar, brenda së njëjtes kategori (III-a);
- b- Të mos kanë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të pakten vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".

Kandidat duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomën e nivelit "Master Shkencor" në fushën juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të pakten 5 vite përvojë në profesion, preferohet në fushën akademike;
- c- Të kenë ngjitur të pakten të një gjuhë të huaj: anglisht, frëngjisht etj.

1.2 DOKUMENTACIONI, MENYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë;
- b- Jeshkrimin i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/66-jeshkrimi-standard>
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomën e marrë jashtë Republikës së Shqipërisë të përcellit njësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërplotimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Votëdhënim të gjendjes gjyqësore;
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori drekt;
- i- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimin, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jeshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen pranë ambjenteve të Shkolles së Magjistraturës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
Këshilli Drejtues

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e ligarjes së rezultateve përfundimtarë i gjeni në Udhezimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al" <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

Në përputhje të vlerësimit të kandidatëve, Shkolla e Magjistraturës do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Shkolla e Magjistraturës, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. NGRITJA NË DETYRE

Vetëm në rast se pozicioni i dorëzimit në fillim të kësaj shpalljeje, në përputhje të procedurës së levizjes paralele, rezultati se është ende vakant, ai është vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngjritjes në detyrë. Këtë informacion do ta marrim në faqen e Shkolles së Magjistraturës, duke filluar nga data 24/02/2018.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nepunësin civil të njëjtes kategorisë (vetëm një kategori me e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngjritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e ulët.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngjritjes në detyrë janë:

- a- Të jenë nepunësin civil i konfirmuar, brenda njëjtes nga kategoria III-a, III-b, IV-a ose IV-b;
- b- Të mos kanë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të pakten vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Zotërojnë diplomën e nivelit "Master Shkencor" në fushën juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të pakten 5 vite përvojë në profesion, preferohet në fushën akademike;
- c- Të kenë ngjitur të pakten të një gjuhë të huaj: anglisht, frëngjisht etj.

2.2 DOKUMENTACIONI, MENYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë;
- b- Jeshkrimin i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeshkrimi-standard>
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomën e marrë jashtë Republikës së Shqipërisë të përcellit njësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërplotimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Votëdhënim të gjendjes gjyqësore;
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori drekt;
- i- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimin, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jeshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen pranë ambjenteve të Shkolles së Magjistraturës.

DIBËR

Arrestohet nënkryetari i Bashkisë, Ernolt Cani. Muharrem Rama: PDIU, bandë horrash, ordinerë

"Lufte" mes PS e PDIU në Bashkinë e Dibrës, përleshjen me shkopinë bejsbolli e shufra hekuri Sherri pas emërimit të drejtorit nga Jugu. Lëndohen 4 punonjës, shoqërohen kryebashkiaku dhe 40 persona

Emërimi i tepelenasit Drini Mataj, drejtor i Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Dibrës si dhe shkarkimet që ai kishte parajlmëruar se do të bëheshin në administratë ka çuar në përplasje mes socialisteve dhe çamëve. Kjo për faktin se nga shkurtimet do të prekeshin punonjësit e bashkisë të sjellë nga PDIU. Përplasia fizike mes punonjësve të bashkisë ka nisur mëngjesin e djeshëm, gjatë mbledhjes së administratës. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se shërra ka nisur, pasi çamët kanë kundërshtuar drejtorin e ri Mataj me arsyen se është sjellë nga Jugu i vendit në Dibër për të larguar punonjësit e emëruar nga PDIU. Mësohet se shërra mes palëve ka degjeneruar në përleshje me grushte, shqelma e sende të forta (shkopinj bejsbolli, shufra hekuri dhe karriqe). Për pasojë kanë mbetur të lënduar 4 persona. Bëhet fjalë për shtetasit: Drini Mataj, Hektor Daci, Erjon Doka si dhe një punonjës tjetër, të cilët u dërguan për ndihmë mjekësore në spital. Pas sinjalizimit për incidentin, policia ka shoqëruar dhe marrë në pyetje kryebashkiakun Muharrem Rama si dhe afro 40 persona të tjerë (punonjës, policë bashkiakë dhe shtetas të tjerë). Ndërsa, është arrestuar nënkryetari i bashkisë së Dibrës, Ernolt Cani, 34 vjeç. Burime zyrtare nga policia e Dibrës pohuan se "nga veri-



Kryetari i bashkisë së Dibrës, Muharrem Rama



Policia pas incidentit në bashkinë e Dibrës

fikimet paraprake dyshohet se disa punonjës të Bashkisë Dibër, të ndihmuar nga persona të jashtëm hynë nga dera e pasme e godinës dhe kanë goditur shëfën e Burimeve Njerëzore të Bashkisë, shtetasin D.M. si dhe shtetasit: H.D., E.D, L.D. Të lënduarit po marrin trajtimin mjekësor në spitalin e Peshkopisë dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën". Ndërkaq, kreu i Bashkisë, Muharrem Rama ka zbardhur shërrin e ndodhur në ambientet e këtij institucioni. Në një lidhje telefonike për "News24", ai tha se 30 persona, përfaqësues të PDIU-së kanë hyrë në

bashki duke ushtruar dhunë. Kryebashkiaku nuk ka mohuar që ishin parajlmëruar largime nga puna, por tha se punonjësit e sjellë nga PDIU kanë performancë të dobët. Ndërsa, përmes një postimi në rrjetin social, Rama ka sulmuar ashpër PDIU-në, teksa ka shkruar se

kanë bërë vetëm një transferim paralel nga drejtori i burimeve njerëzore të drejtor të ndihmës ekonomike. Gjithçka përfundoi me kaq, ky ka qenë debati i ndodhur në bashki? Janë dhunuar zyrat e bashkisë nga përfaqësues të PDIU-së. Çdo të thotë janë dhunuar, ka pasur të lënduar? Janë 4 të lënduar që kanë shkuar në spital. Ata kanë disa plagë në kokë, pasi janë goditur me mjete të forta. Si do vepron zoti Rama, si kryetar i Bashkisë së Dibrës? Sigurisht ne do ndjekim vetëm anën ligjore. Policia e Dibrës ka qenë në gatishmëri dhe po kryen veprimet hetimore.

ambienteve të Shkolles së Magjistraturës. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të bëhet brenda datës: 14/02/2018

2.3 REZULTATET PËR FAZEN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFETESITË DHE CILESITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me: - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përkrahimin e pozicionit të punës; - Eksperienca e tyre të mëparshme; - Motivimi, aspiratat dhe prirshmëritë e tyre për karrierën.

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE NGRITJE NE DETYRE NE KATEGORINE E MESME DHE E ULET DREJTUESE

Përgjegjës i Sektorit të Formimit Fillëstar - Lloji i diplomës "Shkenca Juridike". Niveli minimal i diplomës "Master Shkencor"

Ne zbatim të neni 26, të ligjit 15/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe të Kroatit dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Shkolla e Magjistraturës shpall procedurë të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

1. Përgjegjës i Sektorit të Formimit Fillëstar - Kategorja: III-a

Pozicioni me sipër, i orohet fillimisht nëpunësit civilë të së njëjtes kategori për lëvizjen paralele; rrezultati në rast se në parandalim të procedurës së lëvizjes paralele, rrezultati në ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

PER TË ULET PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NE DETYRE) APLIKOHET NE TË NJEJTES KOHE!

09/02/2018 Afati për dorëzimin e dokumentave për: LËVIZJE PARALELE

14/02/2018 Afati për dorëzimin e dokumentave për: NGRITJE NE DETYRE

Përkrahimi përgjithshëm i punës për profesionistët në sipër është: - Formimi, vlerësimi, këshillimi, analiza, kërkimi dhe zgjidhja e problemeve dhe çështjeve objektive i fushës së veprimtarisë së Sektorit të Formimit Fillëstar.

1. LËVIZJA PARALELE

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:


1.2 DOKUMENTACIONI, MENYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1.5 MENYRA E VLËRESIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATËVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT



SHKOLLA E MAGJISTRATURËS Këshilli Drejtues

jashtë Republikës së Shqipërisë të përcëllt nëjshmi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit:

1.6 DATE E DALJES SË REZULTATËVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

2. NGRITJA NE DETYRE

1.3 REZULTATET PËR FAZEN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFETESITË DHE CILESITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

2.2 DOKUMENTACIONI, MENYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATËVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATËVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATËVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATËVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATËVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATËVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATËVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Këshillit Bashkiak/ Veliaj: Integrim i plotë i këtyre komuniteteve

Shpërndahen 120 banesa për familjet e pastreha në Tiranë

Lista e plotë me emrat e përfituesve

Voltiza Duro

Plot 120 familje të pastreha në nevojë do të përfitojnë strehim social, vendim ky i miratuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës ditën e djeshme. Përkatësisht bëhet fjalë për të gjitha ato familje që preken nga zbatimi i projektit për rehabilitimin e lumit të Tiranës, si dhe familjet rome që jetojnë në zonën e Shkozës. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën me emrat e 120 familjeve përfituese. Shtëpitë e ndërtuara në mjediset e ish-repartit ushtarak dhe të uzinës së autotraktorëve, do të jepen në përdorim pa pagesë për këto familje të pastreha. Kryebashkiaku Erion Veliaj në fjalën e tij, theksoi se secili ka të drejtë të strehohet e të integrohet në komunitet. "Është në nderin tonë të miratojmë listën përfituese dhe dhënien për përdorim të banesave të ndërtuara për strehimin e familjeve të komunitetit rom në Shkozë, nga zbatimi i projektit "New House - New Life". Edhe romët i strehojmë, por edhe qytetit po i kthejmë pak dinjtet. Secili ka të drejtë të strehohet, thjesht jo kudo, jo në Lanë, jo në liqen, jo në breg të lumit!", nënvizoi Veliaj. Projektvendimi i parë trajton familjet e komunitetit rom në Shkozë dhe që përfitojnë nga zbatimi i projektit "New House - New Life: Rehabilitation of Roma Community Settlement". Falë këtij projekti në territorin e quajtur si ish-kombinati i autotraktoreve, Shkozë janë instaluar 60 struktura banimi një katëshe dhe me sipërfaqe afërsisht 35 m², por e variueshme në përputhshmëri me numrin e anëtarëve të familjeve dhe në përputhje me të gjitha standardet e nevojshme për jetesë të përshtatshme dhe komoditet të veprimitarisë sociale për këto familje. Ndërsa projektvendimi i dytë trajton një tjetër problematikë të krijuar si rrjedhojë e zbatimit të projektit të rehabilitimit të lumit të Tiranës. Edhe me këtë projekt përfitojnë rreth 60 familje të tjera, kryesisht rome dhe egjiptiane, që kishin nënëruar barakat e tyre në këtë zonë dhe që zhvendosja e tyre ishte bërë e domosdoshme për zbatimin e këtij projekti. Por që këto familje të nënshkruajnë kontratën e huamarrjes së këtyre banesave duhet të marrin përsipër dhe një sërë detyrimesh që kanë të bëjnë me regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile,

Lista e përfituesve dhe dhënien në përdorim të banesave të ngritura për strehimin e familjeve të prekura nga "Projekti i rehabilitimit të lumit të Tiranës dhe brigjeve të tij dhe të gjitha punimet civile përkatëse"

1. Festim Kasem Mustafaj	Rita Mustafaj	2+1
2. Dritan Festim Mustafaj	Silvana Mustafaj	2+1
3. Paris Sefedin Dajlani	Rita Dajlani	3+1
4. Vladimir Meleq Qerimi	Danjela Qerimi	1 + 1
5. Elvira Agim Basri	Gramoz Basri	1 + 1
6. Esmeralda Sefedin Shukri	Shkelzen Dajlani	2+1
7. Mamudije Rustem Nazifi	Mondi Ymeri(Nipi)	Garsoniere
8. Violeta Agim Dalipi		Garsoniere
9. Zamir Qerim Shahini		Garsoniere
10. Bardhyl Shefqet Ymeri	Arta Ymeri	3+1
11. Besim Demir Mehmeti	Shpresa Mehmeti	Garsoniere
12. Gezim Hamit Ferra	Lule Ferra	2+1
13. Zana Safet Rakipi		3+1
14. Besnik Sali Kovaci	Nexhmije Kovaci	3+1
15. Gentian Agim Xhepa	Emanuela Xhepa	1+1
16. Bashkim Sadedin Basri	Mimozza Basri	2+1
17. Hyqmet Zenel Rustemi		1+1
18. Hamza Besim Demiri	Enverie Demiri	3+1
19. Ardjan Sefedin Daljani	Rudina Daljani	2+1
20. Renato Ardan Daljani	Megi Daljani	1 + 1
21. Besnik Skender Mustafaj		Garsoniere
22. Fadil Hamdi Hyseni		2+1
23. Ilmi Avni Rakipi	Myzejen Rakipi	3+1
24. Albert Avni Rakipi	Merita Rakipi	2+1
25. Mereme Celu Sopoti		Garsoniere
26. Zemerije Haxhi Berisha		3+1
27. Sadete Kurtali Shoshari	Ilirjan Idrizi (i biri)	Garsoniere
28. Migena Haziz Arixhiu	Fatbardh Sadiku	1 + 1
29. Sonila Agim Qerimi		1 + 1
30. Emiljana Nazmi Muharremi		1 + 1
31. Arben Ahmet Zerellari		3+1
32. Mondri Hajdar Pufta		2+1
33. Arnold (i Panjohur)Rushani		Garsoniere
34. Suada (i Panjohur)Rushani	Mario Isai	1+1
35. Lida Abedin Rushani	Abedin Rushani	1 + 1
36. Kujtim Skender Mustafaj	Valentina Mustafaj	2+1
37. Ferdinand Ismail Ymeri	Raimonda Ymeri	1+1
38. Shpetim Ramadan Rustemi	(Mulleti) Suzana Mulleti	1+1
39. Roland Shpetim Rustemi	Dorjana Rustemi	3+1
40. Nexhip Sefedin Sulejmani		1+1
41. Elsa Riza Sadiku	Altin Sadiku	3+1
42. Haxhi Sinan Berisha	Alketa Shahini	1+1
43. Genci Qerim Shahini	Rovena Shahini	2+1
44. Shpetim Haxhi Berisha	Entela Berisha	2+1
45. Luan Qerim Shahini	Meriban Mustafaj	2+1
46. Qerim Aqif Shahini		1+1
47. Albert Ymer Berisha	Edmonda Berisha	2+1
48. Marjana Ilir Ymeri		2+1
49. Robert Mustafa Hysenaj	Manjola Hysenaj	2+1
50. Rudina Meleq Qerimi		2+1
51. Leonard DASHMIR KOSI	Dafina Ko9i	2+1
52. Sulltane Kadri Kallku	Dilaver Kallku	1+1
53. Arben Demiran Mehmeti	Lirije Mehmeti	1+1
54. Agron Ymer Ymeri	Lela Ymeri	1+1
55. Genci Selim Nure		Garsoniere
56. Resmie Gurali Muaremi		Garsoniere
57. Sabri Ali Ruqaja	Lirije Ruqaja	1+1
58. Fatbardh Jonuz Arixhiu	Valbona Arixhiu	1+1
59. Argjentina Haziz Arixhiu	Fadil Rushani	1+1
60. Agim Vasi Karamanllari	Mira Karamanllari	1+1

arsimimin dhe kontrollin mjekësor të tyre.

GJELBËRIMI

Më tej, kryebashkiaku u shpreh se Tirana po përjeton një revolucion të gjelbër, e ndodhet shumë pranë arritjes së objektivit për mbjelljen e 100 mijë pemëve të reja, duke krijuar kështu një mjedis të

shëndetshëm për qytetarët. Por Veliaj bëri me dije se janë marrë një sërë nismash të tjera që do të sjellin një përparim të ndjeshëm të ajrit në qytet si dhe theksoi se kanë mbërritur në Tiranë biçikletat e para të flotës prej 4000 mjeteve bike&go. Gjithashtu, Këshilli Bashkiak ka

bërë me dije se së shpejti do të qarkullojë linja e parë e autobusëve elektrikë në kryeqytet, që do të përshkojë itinerarin nga Pallati me Shigjeta - Porcelan - Rruga e Dibrës - Stacioni i Trenit - Sheshi Shqiponja, për të mbërritur sërish te Pallati me Shigjeta.

LISTA E PËRFITUESVE QË MARRIN NË PËRDORIM BANESAT E NDËRTUARA PËR STREHIMIN E FAMILJEVE TË KOMUNITETIT ROM NË SHKOZË

NR	Emër Mbiemër	Struktura
1.	Krenar Sula (Aida Sula)	1+1
2.	Nisvan Sula (Hane Sula)	G
3.	Ylli Vizani (Fitnetë Vizani)	2+1
4.	Roland Sula (Nora Sula)	G
5.	Bujar Sula	G
6.	Mateo Skureni	G
7.	Ilir Heshtra (Fitnetë Heshtra)	G
8.	Hyqmet Rustemi	3+1
9.	Mide Heshtra (Artur Heshtra)	1+1
10.	Evis Rustemi (Xhoana Rustemi)	2+1
11.	Orkida Driza	2+1
12.	Kujtim Mehmeti	G
13.	Marqis Mehmeti (Zamira Mehmeti)	2+1
14.	Jorgo Mehmeti	G
15.	Sokol Sula (Adine Sula)	2+1
16.	Hotjon Kasha (Valbona Kasha)	3+1
17.	Ejiona Demiri	G
18.	Fatmir Bukri (Silvana Bukri)	2+1
19.	Mijjan Kora (Lindita Kora)	3+1
20.	Edi Sula (Ilijana Demiri)	1+1
21.	Fatime Rustemi	G
22.	Mario Sula (Miranda Sula)	1+1
23.	Arben Mehmeti (Drita Mehmeti)	2+1
24.	Nadire Rustemi	1+1
25.	Lulzim Aliu (Vjollca Aliu)	3+1
26.	Besnik Aliu (Erjona Aliu)	1+1
27.	Mira Aliu	G
28.	Arif Mehmeti (Suzana Mehmeti)	G
29.	Shpetim Mehmeti	G
30.	Dritan Sula (Zana Sula)	1+1
31.	Iljaz Sula	1+1
32.	Emiljan Xhambazi	1+1
33.	Alfred Xhambazi	G
34.	Naxhije Aliu	G
35.	Kujtim Aliu (Mirela Aliu)	3+1
36.	Hektor Xhambazi	2+1
37.	Tasim Mehmeti	1+1
38.	Xhevahir Mehmeti (Miranda Mehmeti)	G
39.	Besnik Mehmeti (Shpresa Mehmeti)	2+1
40.	Isat Sula (Xhemile Sula)	1+1
41.	Luftim Demiri (Elena Demiri)	1+1
42.	Kumbrije Demiri	G
43.	Fatmir Xhambazi (Flutura Xhambazi)	1+1
44.	Engjellush Demiri	1+1
45.	Ardjan Mehmeti (Gentjana Mehmeti)	3+1
46.	Gezim Mehmeti (Thellexna Mehmeti)	3+1
47.	Shpetim Demiri	G
48.	Luan Sula	2+1
49.	Gramoz Mustafa (Aferdita Mustafa)	3+1
50.	Elvira Duda	G
51.	Vjollca Bukri (Rexhep Bukri)	G
52.	Zanajela Demiri	G
53.	Andrea Aliu	1+1
54.	Lutfi Bukri	1+1
55.	Eqon Aliu (Angjela Aliu)	G
56.	Artor Sula (Elsa Sula)	G
57.	Xhafer Kora (Drita Kora)	G
58.	Ferdinand Berati (Kozeta Berati)	2+1

Erion Veliaj: Së shpejti nis ndërtimi i 5 shkollave të reja

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të mbajtur ditën e djeshme është bërë me dije se së shpejti do të nisë ndërtimi i 5 shkollave të reja në kryeqytet. "Loti i parë i 5 shkollave sapo është miratuar, ndërtimi i tyre do të fillojë për punë ditësh në zonën e Laprakës, tek Shqiponja, në Kodër-Kamëz, në Institutin Bujqësor dhe tek Don Bosko. Shkollat në Kodër-Kamëz dhe Institutin Bujqësor do të jenë 2 shkolla me të njëjtin terren, pra edhe 9-vjeçare edhe e mesme. Pra, në total, 5 shkolla që adresojnë fluksin e popullsisë në një zonë jashtëzakonisht të dendur të Tiranës", tha Veliaj. Ky i fundit theksoi se në shtator do të jenë gati edhe dy shkolla të tjera që po ndërtohen aktualisht, çka do të ulin numrin e nxënësve në shkollat ekzistuese. Këshilli Bashkiak miratoi edhe një sërë vendimesh të rëndësishme, sikurse është vendimi për përdorimin e palestrave të shkollave të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas orarit mësimor dhe në ditë e pushimit.



STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELMETA METHOXHA

Dt 05.02.2018 ora 16:00
 Përfundon Ankandi i Tretë për pasurinë:
 "Pasuria "Apartament" me sip. 55 m², Nr. pasurie 212/15-1-5, Z. K 2140, Vol. 2, Fq. 33, me adresë Kërçukal (Gosë), Kavajë. Me çmim 1 247 400 Lekë

Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr. L.11, Biv.kryesor (ish kinma iliria), Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

Mjeku popullor: Përdorni tërfilin ngjyrë mishi për lënien e duhanit

Voltiza Duro

Njeriu duke qenë një qenie biologjike re agon karshi ngacmuesve të jashtëm, tingujve, zhurmave por edhe ndaj marrëdhënieve shoqërore. E kështu që të gjithë ata ngacmues që ndikojnë në sistemin nervor qendror dhe i ndryshojnë veprimtarinë e tij duke i dhënë një devijim anësor nga vija e përgjithshme, futen në grupin e stresit. Në momentin që ka mërzitje, fillon t'i shkaktohet stres. Por edhe një zile telefoni nëse e dëgjimë shpesh, do të na mërzisë e do të na krijojë stres, sepse njeriu dëshiron të reagojë karshi asaj që dëgjon. Këta ngacmues që shqetësojnë sistemin nervor qendror apo periferik bëhen më pas dominuese dhe arrijnë që sistemi nervor dhe endokrin të mos punojnë qetësisht e normalisht, por të punojë i shqetësuar, i mërzitur, i stresuar. Që të gjitha këto ngarkesa sjellin një lodhje dhe manifestohen në ankh, largim nga vetvetja e njëkohësisht edhe organizmi fillon të mbartë këto ngarkesa emocionale. Gjithashtu, të gjitha gjëndrat me sekrecion të brendshëm fillojnë të punojnë keq. Në këto raste njeriu, i ndikuar nga stresi, futet në atë rrethin vicioz që do të preken edhe mëlçia, pankreasi, tiroidja, shpretka, hipofiza e kështu me radhë. Në këto raste, individ fillon të dalë nga vetvetja, fillon të jetë i stresuar, jo i qetë madje të demonstrojë edhe raste frike. Por edhe nga ana fiziologjike, krijojmë një nivel

Ylli Merja: Si të shpëtoni nga stresi, ankthi e depresioni

"Bimët medicinale që iu ndihmojnë"



Mjeku popullor Ylli Merja



tet e menjëhershme pozitive në organizëm. Nëse personat do e kenë të mundur të mbjellin bimën e livandos në shëtitë të tyre, atëherë do të shohin se niveli i stresit do të zvogëlohet.

DUHANPIRJA

Bima e tërfitit ngjyrë mishi rritet në lartësinë në 800-1500 metra mbi nivelin e detit. Në

të lartë të kolesterolit, ngushtim të karotideve dhe një pamjaftueshmëri të sistemit nervor për ta ushqyer me gjak e oksigjen. Ndërkohë truri do të kërkojë ushqim, e zemra nuk arrin ta dërgojë, pasi gjaku është trashur nga faktorë të ndryshëm dhe trupi në vetvete fillon të bëhet nervoz. Ky është një stres i dytë fiziologjik i krijuar nga vetë njeriu pa e ditur atë, por që

ndikon shumë në coroditjen e sistemit nervor. Pas kësaj, shfaqet pagjumësi e dobësim i kujtesës.

TRAJTIMI

Personat e prekur nga stresi mund të pinë një apo dy gota çaj në ditë me bar blete për të bërë një gjumë më të qetë. E më tej duhet të kryejnë edhe diagnostikim të nevojshme të mjekët. Ndërsa, ankthi nuk është asgjë tjetër veçse frikë, e diku

janë prishur ato balancat e cipave të trurit. Nëse konsumohet çaj trëndafilil apo murziri, do të vihen re efek-

momentin që ky tërfil përzihet me duhanin, arrin të neverisë cigaren e çon deri në lënien përfundimtare të këtij vesi. Kjo bimë ka një magji çudibërës, e pasi e përziejmë me duhanin, mund të konsumohet njësoj siç pihet një cigare, në raportin 1:1. Ndërsa për personat, mushkëritë e të cilëve janë rënduar së tepërmi nga duhanpirja, këshillojmë që të shtojnë edhe pak sherebelë në përzjerje apo zhumbicë. Të tria këto bimë së bashku arrijnë të krijojnë idenë që je i ngopur me duhan. Tërfilli ngjyrë mishi në këtë rast shërben si një balancues e frenues i hormonit të mosngopjes, në mënyrë që ky i fundit mos të japë efektin e vet në gjak. I gjithë ky proces vjen duke rrulluar cigaret që pi individ, jo si një ndërprerje e menjëhershme, nga dy paketa rrallohet në 30, 20, 15 cigare e kështu me radhë. Shumë shpejt ndihen edhe efektet fiziologjike, pasi mushkëria fillon të bëjë një vetëpastrim, prandaj ne i hedhim përzjerjes pak zhumbicë apo sherebelë. Më tej fillon nxjerrja jashtë e sekrecioneve e njëkohësisht përdoruesit nëse do të përziejnë duhanin me këtë tërfill nuk duhet të bëhen merak pasi urina do të fillojë të ndryshojë ngjyrën.

Shezair Rrokaj: Fillimisht të bëhet pilotimi

Nisma "3 lëndë në 6 orë", debate të ashpra mes Nikollës e deputetëve të opozitës

Me debate të shumta shoqëruar mbledhja e Komisionit të Medias dhe Edukimit mbi nismën e re "3 lëndë në 6 orë", që pritet të implementohet duke nisur nga sot. Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla ka qenë e pranishme gjatë takimit për të sqaruar projektin që do të prekë arsimin parauniversitar në vend. Ndërkohë, Shezair Rrokaj dhe Luçiano Boçi, të dy deputetë të opozitës kanë kërkuar që fillimisht të bëhet pilotimi i nismës. "Mos duhet ta pilotojmë në fillim. Bëni një hap prapa për ta zhvendosur në shtator, duke e pilotuar nëpër shkollat dhe për të marrë një feedback më të gjerë. Ne duam të bëjmë si Holanda, por këtu nuk është Holanda, as Filanda", tha Rrokaj në fjalën e tij. Ndërkohë, Boçi ka insistuar që kjo nismë të mos vihet në jetë, pasi sipas tij, e gjithë kjo



është një marrëzi. Më tej, kryetarja e komisionit, njëkohësisht edhe deputete e PD-së, Albana Vokshi ka kërkuar nga ministria një përgjigje se nga kush është ndërmarrë

kjo nismë. "Pra kush e ka iniciuar, pse nuk ka një studim, cilat janë modelet? Kush ka punuar, kush është grupi i punës, ku janë psikologët? E kemi me qetësi, është për fëmijët tanë, nuk është për propagandë", - iu drejtua Vokshi ministres Nikolla. Kjo e fundit sqaroi se kjo nismë ka efekt pozitiv si për nxënësit, edhe për mësuesit. "Është një grup mësuesish, prindërisht, por edhe disa nxënës janë mbledhur, si ata vetë e kanë publikuar në atë takim që keni parë dhe kanë dërguar në portalin e bashkëqeverisjes një propozim konkret për këtë nismë", - tha Nikolla.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra përmbarimore "Best 2018"

SHPLLJJE ANKANDI

Me datë 12 shkurt 2018 nga ora 08:00-ora 16:00 tek kjo zyre përmbarimore do zhvillohet ankand i tre për shifren e tre parcelave të ndodhura në L. 13, ZK 8518, Plazh, Durrës e konkretisht pasqarë nr 5854/vol 17, fq 2, 5856/fq 3, 5857, fq 4. Cdo titull ka sipërfaqen prej 400 m² dhe mbi të vendon një manivelloje-sipërfaqe.

Cmimi fillësar me të cilin hapet ankandi do të jetë:

1) për pasurinë 5854 është 570000 Euro, 2) për pasurinë 5856 është 570000 Euro, 3) për pasurinë 5857 është 198892 Euro.

P.s: Çyrtatërishtësi që deshtojnë të marrin gjyqe në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të cmimit fillësar si garancë për gjyqemarrje në ankand. Kjo garancë pasurore duhet të jetë e dërritur në BKT, rr. Ilgjasitë, Shtetë Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLALLA).

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tëlf ax: 052-22-6000

E-mail: best2018@permbarues.al, web: www.permbarues.al

105
1912 - 2017
POSTA SHQIPTARE

PAGUAJ NË POSTË FATURAT E ENERGJISË, UJIT, KËSTET E KREDISË, ETJ.

- * Proces i garantuar direkt në sistemin online
- * Apliko për kredi bankare në çdo sportel të postës
- * Shërbime në zyrat postare në 7 ditë të javës

SHPEJT. SIGURT. KUDO.

POSTA SHQIPTARE

www.postashqiptare.al

EULEX-i ende nuk e ka pushuar procedurën gjyqësore për të akuzuarit për krime luftarë ndaj popullatës civile, edhe pas 15 ditësh nga vrasja e Oliver Ivanoviçit. Misioni Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë ka konfirmuar për gazetën "Express" se procedura gjyqësore ndaj politikanit serb të vrarë para më shumë se dy javësh nuk është pushuar akoma. "Aktvendimi i cili do të tregojë se procedura do të ndërpritet për shkak të vdekjes së të akuzuarit, Oliver Ivanoviç, ende nuk është nxjerrë", është përgjigjur me e-mail EULEX. "Në momentin kur të nxirret ky aktvendim do të bëhet publik", thotë ky mision përmes zëdhënës

Eulex: S'është nxjerrë aktvendimi për ndërprerjen e procedurës

Akuzohej për krime luftarë, Oliver Ivanoviç ende në gjyq

EULEX

"Aktvendimi, i cili do të tregojë se procedura do të ndërpritet për shkak të vdekjes së të akuzuarit, Oliver Ivanoviç, ende nuk është nxjerrë", është përgjigjur me e-mail EULEX. "Në momentin kur të nxirret ky aktvendim do të bëhet publik", thuhet përmes zëdhënës Donika Berisha-Rizaj.

Donika Berisha-Rizaj. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, aktvendimin për pushimin e procedurës penale e merr prokurori i shtetit kur gjatë

rrijdhës së procedurës penale vërtetohet se i pandehuri ka vdekur. Ish-lideri i vrarë i SDP-së, Oliver Ivanoviç ka qenë duke u gjykuar për krime luftarë në Kosovë, përf

shirë vrasjen dhe dëbimin e popullatës civile shqiptare gjatë prillit të vitit 1999 në Mitrovicë. Në fakt, procesi ndaj tij ka qenë në rigjykim, pasi Gjykata e Apelit e ktheu rastin në pikën zero, shkurtin e vitit të kaluar. Një vit më herët, më 21 janar 2016, Gjykata Themelore në veri të Mitrovicës e kishte gjetur fajtor për krime luftarë ndaj shqiptarëve, politikanin serb Oliver Ivanoviç, duke e dënuar me 9 vite burgim. Sipas këtij aktgjykimi që Apeli e



kishte kthyer për rigjykim, Oliver Ivanoviç kishte marrë pjesë në vrasjen e të paktën katër burrave shqiptarë dhe femijëve nga shtëpitë e tyre në Mitrovicë në vitin 1999. Por, gjykata nuk kishte arritur të bindet se ish-mjeshtri i arteve mar-

cialle kishte qenë komandues i këtij krimi. Me të njëjtin aktgjykim, Gjykata Themelore e Mitrovicës i kishte liruar nga të njëjtat akuzat katër serbë tjerë të dyshuar si bashkëpunëtorë të ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, tashmë të vdekur: Oliver Ivanoviç u vra me gjashtë plumba mëngjesin e 16 janarit 2018, ndërsa po shkonte me këmbë në zyrën e partisë së tij SDP në veri të Mitrovicës. Ivanoviç, menjëherë pas luftimeve u bë politikan i serb me i pranueshëm nga shqiptarët e Kosovës. Me vite të tëra, serbi i lindur në Deçan habiste shqiptarët dhe serbët në të njëjtin kohë deri kur ndaj tij, EULEX ngriti aktakuzën për krime luftarë dhe vrasjen e 49 shqiptarëve, përfshirë 20 viktimat e Lagjes së Kovaçevës.

Revista amerikane: Haradinaj, një ndër 5 politikanët që ka tërhequr vëmendjen e botës

Kryeministri kosovar në listën e 'The Time': S'është mirë të jesh i kërkuar

Akuzohet për krimet e luftës, media e SHBA: Politikani "i rreptë" mund të shndërrohet në hero

Nuk është gjithmonë ngjërë e mirë të jesh i kërkuar. Në një kohë të dramës së madhe gjeopolitike, revista "Time" ka publikuar një listë të personazheve "më të kërkuara" që kanë tërhequr vëmendjen e botës dhe ajo që historitë e tyre specifike na tregojnë për gjendjen e globit në 2018. Pesë më të kërkuarit ishin Ramush Haradinaj i Kosovës, Carles Puigdemontit të Katalunias, Fethullah Gulenit të Turqisë, Julian Assange të SHBA-ve dhe Mikheil Saakashvilit të Gjeorgjisë. "Shpesh nuk është mirë të jesh i kërkuar. Në kohëra të dramave gjeopolitike, këtu keni disa prej personazheve të rreptë që janë 'më të kërkuarit', të cilët kanë fituar vëmendjen e botës", shkruan "Time" për pesë personazhet e këtij artikulli. "Time" shkruan se Haradinaj bëri emër gjatë konflikteve të viteve '90 në Kosovë. Në këtë artikull prestigjiozja amerikane tregon se tani kryeministri i Kosovës ishte komandati i UÇK-së, i akuzuar për torturë dhe vrasje të serbëve, i cili në mungesë të provave ishte shpallur i pafajshëm nga Tribunali i Hagës gjatë viteve 2008 e 2012. "Kjo nuk është e mjaftueshme për Serbinë, e cila refuzon të njohë Kosovën si shtet të pavarur dhe dëshiron që Haradinaj të ekstradohet për t'u përballur me drejtësinë e saj", ka shkruar "Time". "Nuk është vetëm Serbia nga e cila Haradinaj po përballlet me sfida. Me urdhër të aleatëve perëndimorë dhe të ndihmuar nga BE-ja, parlamenti i Kosovës në vitin 2015 u pajtua që të krijonte një gjykatë speciale për krime të luftës me bazë në Holandë, por do të operonte nën juridiksionin e Kosovës. Kjo lëvizje u konsiderua si instrumentale në stabilizimin



Mikheil Saakashvili



Fethullah Gulen



Carles Puigdemont



Julian Assange

e gjeopolitikës në Ballkan. Vetëm tani ka paralajmërim për shfuqizimin e saj (Speciales). Haradinaj dhe elita politike e Kosovës është duke shikuar për mundësitë e shmangies së kësaj gjykate", ka shkruar "Time". "Nganjëherë, të jashtëligjshmit si Assange, Puigdemont, Gulen dhe Haradinaj, mund të shndërrohen në heronj për ata që kundërshtojnë ata që duan t'i burgosin", shkruan në fund të artikullit revista amerikane. "Kryeministri i



Ramush Haradinaj

Ramush Haradinaj u bë i njohur në fund të viteve '90 gjatë konfliktit në Kosovë. Si Komandant i UÇK-së, ai u akuzua për vrasjen dhe torturimin e serbëve, por për shkak të mungesës së provave, Haradinaj u shpall i pafajshëm nga Gjykata e Hagës në 2008 dhe 2012. Megjithatë, kjo nuk mjaftoi për Serbinë, e cila refuzon të njohë Kosovën si shtet i pavarur dhe kërkon ekstradimin e Haradinajt për t'u përballur me akuzat në gjykatat serbe. Sidoqoftë,

Haradinaj nuk përballlet me sfida ligjore vetëm në Serbi. Me kërkesë të aleatëve perëndimorë dhe të ndihmuar nga fondet e BE-së, parlamenti i Kosovës ra dakord në 2015 të krijonte një Gjykatë Speciale për Krimet e Luftës. Vetëm tani që aktpaditë e para priten të paraqiten, Haradinaj dhe pjesëtarë të tjerë të elitës politike të Kosovës po kërkojnë të gjejnë mënyra që të devijojnë hetimet e saj. SHBA dhe BE janë shumë të ndjeshme se si perceptohen normat dhe vlerat europiane nga Kosova. Ndoshta Haradinaj dhe aleatët e tij mendojnë se Kosova është shumë e vogël për fuqitë e rëndësishme gjeopolitike. Realiteti është se për të ruajtur paqen, ata nuk mund të bëjnë dot ndryshe.

SHKURT

Presidenti Trump zbut qëndrimin për emigrantët

Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump, ka zbutur tonet e ashpër kundër emigrantëve dhe i ka shtrirë dorën e bashkëpunimit në Kongres rivalëve demokratë, në fjalimin vjetor i gjendjen e vendit, i njohur botërisht si "State of the Union". Përpara dhomës së përfaqësuesve, Trump shpallosi planin e ri për emigrantët e jashtëligjshëm. Presidenti la të kuptohet se askush nuk do të dëbohet, pas shfuqizimit të të ashtuquajturit "ligj të ëndërrimtarëve" miratuar nga administrata "Obama". Për politikën e jashtme, presidenti pretmoi se nuk do të tërhiqet nga presioni i fortë ndaj regjimit të Penanit, që me raketat e reja kërcënon territorin amerikan. Ndërsa tha se nuk do të tërhiqet nga beteja kundër Shtetit Islamik.

Pronari i kërkon seks gruas për t'i dhënë falas banesën me qira

Është zënë në grackë një pronar i një apartamenti në Uells të Britanisë së Madhe, i cili është filmuar nga kamera e fshehtë kur ishte duke i ofruar një gruaje banesë me qira pa pagesë, në këmbim të favorëve seksuale. Mediat britanike shkruajnë se së fundmi në Uells është përhapur një fenomen i ri, ku pronarët e shtëpive ofrojnë qira falas apo me çmim të reduktuar në këmbim të seksit apo një forme tjetër të pagesës. Këto shprehje reklamohen për tyre në internet me sloganin "jepen me qira përmes një pagese alternative". Ka qenë gazetarja investigative, ajo që e filmoi, të cilës i kërkoi favore seksuale një herë në javë dhe në këmbim do t'i ofronte apartamentin me qira falas.

VULLNET KRASNIQI:

Njëri prej organizatorëve të kësaj proteste, Vullnet Krasniqi ka thënë se tashmë prej 17 vitesh shteti i Kosovës nuk ka ndërmarrë masa ndaj ndotjes së ajrit. "Duam ajër të pastër. Nuk është koha të flisni, duam përgjegjësi për ajrin e ndotur. Nuk duam më fjalë, duam veprime konkrete", ka thënë Krasniqi.



Protesta e qytetarëve të Prishtinës

ALBENA RESHITAJ:


"Pra, është koha e qytetarit dhe të protestojmë për t'i gjetur një zgjidhje kësaj problematike të rrezikshme. Ne, qytetarët e Prishtinës, kërkojmë që kjo çështje të merret seriozisht nga qeveria dhe pushteti lokal. Koha po kalon dhe ne nuk po shohim asnjë plan konkret e të detajuar për të zgjidhur problemin e ndotjes. Secili nga ne jemi viktimë dhe askush nuk pret një mrekulli me shkop magjik për problemin", tha ministria e Ambientit, Albena Reshitaj.

Shifrat alarmante të ndotjes, Vullnet Krasniqi: Nuk duam fjalë, duam veprime

Protestë në Prishtinë, qytetarët: Kërkojmë ajër të pastër

Rritja e nivelit të papastërtisë, qeveria ndalon qarkullimin e automjeteve

Ditën e djeshme qindra qytetarë protestuan në qendër të Prishtinës për shkak të shkallës së lartë të ndotjes së ajrit. Ditët e fundit, cilësia e ajrit, sipas matjeve zyrtare, është e rrezikshme për shëndetin e njerëzve. "Duam ajër të pastër", janë dëgjuar brohoritma e masës së tubuar. Për 17 vjet, institucionet e Kosovës nuk kanë bërë asgjë për ajrin dhe ambientin, thanë protestuesit. Gjendja e krijuar me cilësinë e dobët të ajrit, u tha gjatë protestës, po rrezikon shëndetin e qytetarëve. Ata kanë kërkuar përgjegjësi nga organet lokale dhe qendrore. Protestuesit e mbledhur në sheshin "Skënderbeu" kanë marshuar deri te ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, ku kanë vendosur pankartat me mesazhe kundër ndotjes së ajrit. "Helm"... "U ngufatëm"... "Kontrollo cilësinë e naftës"... "Ajër", ishin disa nga mesazhet në parullat që mbanin në duar protestuesit. Nga dita e mërkurë, në qytetin e Prishtinës ka nisur të zbatohet vendimi, i cili parasheh një varg masash nga komunat dhe qeveria e Kosovës për uljen e nivelit të ndotjes së ajrit. Sipas një vendimi të lëshuar të martën nga kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, është ndaluar shitja e thëngjillit brenda territorit të Prishtinës, si dhe qarkullimi i të gjitha automjeteve brenda qendrës së qytetit nga ora 6 deri në orën 22. Aktualisht qarkullimi u lejohe vetëm veturave të transportit publik, automjeteve emergjente të policisë, të misioneve diplomatike, të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të EULEX-it, taksive të



329

IQA
Alarmante, ndotja e ajrit në Prishtinë arrin shifra të larta Cilësia së ajrit sipas ambasadës amerikane në Prishtinë vazhdon të jetë e rrezikshme. Në bazë të matjes së fundit që ka bërë ambasada në orën 18:00, ndotja e ajrit është mjaft e rrezikshme, ajo madje arrin shifrën 317. Shifër kjo shumë herë më e madhe se sa norma e lejuar e ndotjes së ajrit. Në uebfaqen e saj, ambasada këtë AQI e radhit si të rrezikshme, shkruan "Zeri.info". "AQI e rrezikshme është mbi 300. Kjo do të shkaktoje alarm shëndetësor të nivelit të gjendjes së jashtëzakonshme. Gjasat janë më të mëdha që e tërë popullata do të preket". Gjendje e rrezikshme e ajrit paraqitet edhe në aplikacionin për kontrollin e ndotjes së ajrit "Air Visual". Sipas këtij aplikacioni, Kosova radhitet vendi i dytë më i ndotur në botë, ku shkalla e ndotjes së ajrit është mjaft e rrezikshme, 329 IQA. Ndërsa në vendin e parë radhitet Dhaka në Bangladesh me 370 IQA.

PARULLAT:
Protestuesit e mbledhur në sheshin "Skënderbeu" kanë marshuar deri te ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, ku kanë vendosur pankartat me mesazhe kundër ndotjes së ajrit. "Helm", "U ngufatëm", "Kontrollo cilësinë e naftës", "Ajër" ishin disa nga mbishkrimet në parulla parullat.

VENDIMI I QEVERISË PËR NDOTJEN E AJRIT:
Nga e mërkura në Prishtinë ka nisur të zbatohet vendimi, i cili parasheh një varg masash nga Komuna dhe qeveria e Kosovës për uljen e nivelit të ndotjes së ajrit. Sipas një vendimi është ndaluar shitja e thëngjillit brenda territorit të Prishtinës si dhe qarkullimi i të gjitha automjeteve brenda qendrës së qytetit nga ora 6-22.

licencuara. Komuna e Prishtinës ka ndërmarrë këto masa pas të dhënave të Ambasadës Amerikane në Kosovë, të cilat kanë treguar se vlerat e grimcave të PM-së anë disa herë jashtë normales. Dhjetëra qytetarë u mblodhën para Teatrit Ko-

mbëtar për të protestuar kundër ajrit të ndotur në Prishtinë. Njëri prej organizatorëve të kësaj proteste, Vullnet Krasniqi ka thënë se, tashmë prej 17 vitesh shteti i Kosovës nuk ka ndërmarrë masa ndaj ndotjes së ajrit. "Duam ajër të pastër. Tashmë nuk është koha të flisni, duam përgjegjësi për ajrin e ndotur. Nuk duam më fjalë, duam veprime konkrete", ka thënë Krasniqi. Ndërkohë që para disa ditësh, ministria e Ambientit, Albena Reshitaj, mes tjerash në një reagim të saj ka thënë se "gjërat nuk zgjidhen me shkop magjik". Partia Ekologjike ka kërkuar nga qeveria që ta marrë me më shumë seriozitet ndotjen. Një hapje e dritares e tregon realitetin e ndotjes së tmerrshme të ajrit në Prishtinë dhe mushkëritë tona, si dhe shëndeti ynë po shkatërrohet duke u ekspozuar në këtë ajër, mjegullë e smog", shkruan në njoftimin për protestë. "Pra, është koha të protestojmë për të gjetur një zgjidhje për këtë problematikë të rrezikshme. Ne, qytetarët e Prishtinës, kërkojmë që kjo çështje të merret seriozisht nga qeveria dhe pushteti lokal. Koha po kalon dhe ne nuk po shohim asnjë plan konkret për të zgjidhur problemin e ndotjes".

IN MEMORIAM

ALEKSANDËR STIPÇEVIÇ

Arbneshi i Zarës që vërtetoi autoktoninë e ilirëve dhe shqiptarëve

Nga Akademik Muzafer Korkuti*

Në vitin 2015 u nda nga jeta albanologu i shquar Aleksandër Stipçevic. Ai ishte arkeolog, bibliograf, etnograf, ish-te shkencëtar dhe personalitet i shquar, që me përkushtim dhe argument shkencor mbrojti autoktoninë e ilirëve e të shqiptarëve dhe vendin e rëndësishëm të tyre në historinë e Ballkanit Perëndimor.

Me veprimtarinë shkencore të A. Stipçevicit jam njohur 50 vite më parë, kur pata rastin të marr librin "Ilirët", Prishtinë 1967, të përkthyer nga italishtja nga prof. Z. Mirdita. I nxitur nga interesi e vlera shkencore e librit, edhe për lexuesin në Shqipëri, i cili në atë kohë, kishte mundësi shumë të kufizuara për t'u njohur me literaturën e huaj, botova një recension, ku ndër të tjera kam shkruar: "Pas veprës së Karl Paçit 'Ilirët', përkthyer e botuar shqip në Tiranë në vitin 1923, vepra e A. Stipçevicit shënoi një sukses të ri në fushën e ilirologjisë". (Studime historike 1968, 4, f. 201-206).

Në Kuvendin e Dytë të Studimeve Ilire, që zhvilloi punimet në vitin 1985 në Tiranë, ishte i ftuar edhe A. Stipçevic, kështu u njohëm e vazhduam miqësinë, bashkëpunimin e shkëmbimit të literaturës deri në fund të jetës së tij. Pjesë-marrja e Stipçevicit në këtë Kuvend dhe njohja direkt me rezultatet e kërkimeve arkeologjike në Shqipëri e zgjeruan në mënyrë cilësore dijen për historinë dhe kulturën e ilirisë së Jugut, për vendin dhe rolin që ata kanë pasur në historinë antike të Ballkanit Perëndimor. Të gjitha këto A. Stipçevic i pasqyroi në ribotimin e zgjeruar të librit, të botuar më parë në Prishtinë e në vitin 2002, në Tiranë nga shtypshkronja "Toena". Libri është zgjeruar në mënyrë cilësore me pjesët "Simbolet e kultet të ilirët", "Struktura e simbolizmit ilir, prejardhja dhe zhvillimi i simbolizmit ilir dhe mbeturina e simbolizmit ilir në kulturën e mëvonshme në Ballkan".

Veprën e prof. A. Stipçevicë karakterizon përpjekja e vazhdueshme për të plotësuar, saktësuar e thelluar çështjet që trajton në vazhdimësi, siç është edhe qëndrimi i tij për çështjen e origjinës së ilirëve. Kështu, në intervistën e vitit 1985 ("Bota e re", Prishtinë), ai në mënyrë thelbësore ka shprehur qëndrimin kur shkruan "Çdo tregim për Ballkanin fillon me ilirët: Të gjitha ato fise, apo, siç i



Aleksandër Stipçevic

quajmë, popuj, të cilët kanë jetuar në pjesën perëndimore të Ballkanit e që i quajmë ilirë, sheshazi shihet se, pavarësisht nga dallimet, kanë pasur mjaft elementë të përbashkëta, në bazë të cilave mund të flitet për ilirët si një "lidhje", si tërësi fisesh të ndryshme me përbashkësi të mjaftueshme.

Qëndrimet e pikëpamjet e prof. A. Stipçevicit janë të qarta edhe për banorët e Ballkanit Perëndimor në periudhën e vonë antike. Me rëndësi është konstatimi i tij, se me gjithë depërtimin e kulturës e qytetërimit romak, ilirët vazhduan të flasin gjuhën e tyre, të adhurorin perënditë e tyre dhe të vdekurit i varrosnin në mënyrën e tyre tradicionale, i veshin kostumet e tyre popullore dhe përcjellin rendin shoqëror politik të organizimit të tyre fisnor. Nga këto pohime del qartë qëndrimi i tij se nuk flitet për romanizim të ilirëve dhe as për asimilim e zhdukje të tyre, gjë që dëshmohej nga të dhënat që sjell

Muzafer Korkuti: Akademiku kujton njohjen më 1985, në Kuvendin e Dytë të Studimeve Ilire

autori për vendbanimet, kultet, për disa perandorë romakë me origjinë ilire dhe kontributin e tyre në jetën politike e kulturore, në ekonominë etj. Në vazhdim të kësaj pikëpamjeje që A. Stipçevic u bën mbeturinave ilire në Ballkan çon në vazhdimin logjik të banimit të trojeve ilire nga e njëjta popullsi. Depërtimi i kulturës dhe qytetërimit romak nuk ndryshoi përbërjen etnike të banorëve, ata shkruan A. Stipçevic - vazhdojnë të flasin gjuhën e tyre, adhurojnë perënditë e tyre; të vdekurit i varrosin në mënyrë tradicionale, punojnë tokën ashtu siç e kanë punuar me shekuj të parët e tyre, i veshin kostumet e tyre popullore dhe e përcjellin rendin shoqëror e politik të organizimit të tyre fis-

nor, që vetëm në rast nevojë i adoptojnë strukturën e administratës romake.

Karakterit enciklopedik i veprës së prof. A. Stipçevicë dëshmohej edhe në kreun ku trajton jetën e përditshme dhe doket tek ilirët. Autori ka shfrytëzuar të dhënat e fragmentuara që gjenden në veprat e autorëve antikë si edhe një mori faktesh që vijnë nga gërmimet arkeologjike. Duke bashkërenduar të dhënat e shkruara me ato të kulturës materiale, ka mundur të rindërtonte qoftë edhe në formë hamendësimi, disa nga aspektet e jetës së ilirëve si, armatimet e një luftëtari ilir, stolltë e gruas ilire, elemente të veshjes. Autori ka shfrytëzuar të dhëna, ndonëse të kufizuara, për të ndriçuar aspekte të jetës së ilirëve si për tatuazhin, higijenën, sëmundjet, ilaçet që përdornin ilirët etj. Duke grumbulluar copëza nga burimet e shkruara e nga gjetja e objekteve të kulturës materiale flet për bujqësinë, blegtorinë, gjuhën, peshkatarinë, xeh-tarinë, për minierat e krypës, prodhimin e qelqit, rrugët tregtare, monedhat etj. Qëmtimi, grumbullimi dhe sistemimi i të dhënave qoftë edhe të fragmentuara, ashtu siç vijnë nga lashtësia, mundësojnë rindërtimin në formë hipotekore të aspekteve të jetës së përditshme

të stërgjyshërve tanë. Një vlerë të tillë ka trajtesa për jetën shpirtërore, për religjionin, totemizmin, artin figurativ, doket mortore, muzikën, vallet, shkrimin e gjuhën e ilirëve.

Veprimtaria shkencore e A. Stipçevicit karakterizohet nga përditësimi e korrektesa shkencore në plotësimin e veprës me të dhënat e reja, si edhe me rishikimi e pikëpamjeve në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike. Kjo dëshmohej më së miri në botimin në shqip të veprës "ILIRËT, historia, jeta, kultura, simbolet e kultit", Tiranë 2002, ku janë përfshirë tërësisht pjesët të reja si "Simbolet e kultit të ilirët". Në këtë shtojcë prej 196 f., e cila mund të ishte edhe një libër më vete, si nga trajtesa e veçantë dhe e detajuar e kulteve të ilirëve, e simbolizmit religjioz, ashtu edhe nga vëllimi është një ndihmesë e re cilësore për njohjen e jetës shpirtërore të banorëve të tejlashhtë të vendit tonë.

Karakterit enciklopedik i veprimtarisë së A. Stipçevicit provohet katërçipërisht edhe në drejtimin shkencor të Bibliotekës së Akademisë së Shkencave të Kroacisë, ku ka dhënë një ndihmesë të shquar në përpunimin metodik e shkencor të librit. Ai është autor i bibliografisë analitike të ish-Jugosllavisë dhe autor i veprës "Povjesknigi" (Historia e librit), Zagreb 1985, f.560, shoqëruar me shumë ilustrime, vepër e përkthyer në shqip e botuar në Prishtinë 1988 dhe ribotuar në Tiranë në vitin 2000. Libri karakterizohet nga një informacion i hollësishtëm e i dokumentuar, i përhapjes së shkrimit dhe librit në botë, duke iu përmbajtur karakterit kronologjik e gjeografik të përhapjes së tij.

Rrëfimin për historinë e librit, autori e nis me pllakat prej balte të shkruara, të gjetura 4500 vjet më parë në Mesopotaminë e lashtë, e në vijim me shkrimin në Lindjen e Mesme e të Largët, me librin në botën greko-romake, në Mesjetën evropiane, në Perandorinë Bizantine, në botën arabe, në Lindjen e Largët në Mesjetë, në civilizimet parakolumbiane të Amerikës, në periudhën e Rilindjes Evropiane, e deri tek libri e bibliotekat në shek. XX. Vepra "Historia e librit" e Stipçevicit është realizimi enciklopedik më i plotë që njohim për historinë e librit, e botuar deri më sot.

Aleksandër Stipçevic ishte shkencëtar dhe personalitet i shquar shoqëror, që me veprën e tij shkencore enciklopedike hyn në radhën e albanologëve më në zë të dekadave të fundit.



KERKESA



Xhamadani i Isa Boletinit



Isa Boletinit



Ora e Isa Boletinit

Kosova i kërkon Shqipërisë orën e xhamadanin e Isa Boletinit

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës, Kujtim Gashi, ka qenë në Tiranë për të realizuar vizitën e tij të parë zyrtare, me ç'rast ka takuar homologen e tij, ministrin e Kulturës, Mirela Kumbaro Furxhi.

Sipas njoftimit të Ministrisë së Kulturës së Kosovës, ministri Gashi gjatë takimit me ministrin Kumbaro ka diskutuar për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit midis dy ministrive përkatëse në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore dhe atë të drejtës së autorit, duke krijuar edhe hapësira dhe mundësi për intensifikim e bashkëpunimit edhe ndërmjet skenës së pavarur kulturore të të dyja vendeve.

MK e Kosovës bën me dije se ndër temat konkrete të bashkëpunimit të dy Ministrive të Kulturës, asaj të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë për vitin 2018 u nënvizua nënshkrimi i kalendarit të përbashkët kulturor, si një

traditë e mirë dhe shumë domethënëse për kulturën në të dyja vendet, gjë e cila do të ndodhë brenda muajit shkurt. Marrë parasysh që viti 2018 është shpallur edhe Viti mbarekombëtar i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, dy ministrat u pajtuan që të ketë më shumë aktivitete për të shënuar këtë përvjetor me rëndësi për shqiptarët.

Ministri Gashi me këtë rast ka kërkuar nga ministrja shqiptare “huazimin” e disa ekspozateve që i përkasin Heroit Kombëtar Isa Boletinit, për të qenë pjesë e ekspozitës së përhershme në Muzeun e Kosovës, që do të hapet më 17 shkurt – Përvjetorin e Dhjetë të Pavarësisë së Kosovës, duke theksuar se ekspozimi i gjërave që i përkasin Isa Boletinit në Muzeun e Kosovës është një ngjarje me rëndësi për kulturën dhe historinë tonë, meqë kjo është një dëshmi që personalitetet nga Kosova kanë dhënë shumë për çështjen kombëtare. “Një kërkesë tjetër që ia adresova ministres, ekzistojnë



Ministri Kujtim Gashi gjatë takimit me ministrin e Kulturës Kumbaro

“Ekspozimi i gjërave që i përkasin Isa Boletinit në Muzeun e Kosovës është me rëndësi për kulturën”

6 objekte në Muzeun Kombëtar të Shqipërisë, objekte të Isa Boletinit, përfshirë xhamadanin, orën dhe disa vegla tjera, ku kërkova

që këto të na sjellin përkohësisht në Kosovë, t'i kemi në ekspozitën e përhershme, të cilën jemi duke e përgatitur për ta hapur më 17 shkurt”, theksoi Gashi.

Ministri Gashi ka shtuar: “Biseduam po ashtu rreth aktiviteteve të përbashkëta që do t'i kemi edhe me shënimin e 10-vjetorit të vitit jubilar të shpalljes të Pavarësisë të Kosovës, për çka kërkova që të kemi edhe aktivitete të përbashkëta Kosovë-Shqipëri”.

Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro, tha se fokus i diskutimit i homologun e tij kosovar ishte përgatitja për kalendarin e përbashkët kulturor Shqipëri-Kosovë, si dhe diskutuar për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kulturore të dy vendeve.

Ministri Gashi gjatë ditës ka vizituar edhe Muzeun Kombëtar të përgjimeve “Shtëpia e gjetheve” si dhe ka takuar drejtues të institucioneve të kulturës në Shqipëri.

Manipulimi i parë i një fotoje shqiptare dhe trashëgimia historike

Ky imazh përkon me manipulimin e parë të një imazhi në historinë e fotografisë shqiptare. Me shumë gjasa i përket një reklame të kohës. Në të paraqiten i biri i doktor Gennaro Simini, Giacinto, njëherë në rolin e kirurgut me sëpatë në dorë, njëherë tjetër në rolin e pacientit me këmbën e këputur dhe në fund si klient me dorën drejtuar nga spitali i hapur nga i ati, që duket sikur fton qytetarët për t'u shëruar aty, shkruan muzeu “Marubi”.

Kjo është ajo që trashëgojmë. Ndërkaq, në një bashkëbisedim në muzeun “Marubi” është folur për “artin bashkëkohor dhe trashëgiminë fotografike”.

Biseda u bë në kuadër të përmblylljes së ekspozitës “Urtësi sot e mot” të artistes Lala Meredith-Vula. Muzeu “Marubi” në bashkëpunim me De Montfort University Leicester organizon një konferencë, që trajton rolin e fotografisë në raport me trashëgiminë kulturore dhe artin. Duke u nisur



Foto e manipuluar, Marubi

nga rëndësia e arkivave fotografikë, sot vëmë re një rritje të përdorimit të trashëgimisë kulturore në praktikën e artit bashkëkohor. Si perceptohet e kaluara përmes tyre, nga ana politike dhe estetike? Si kjo e kaluar dhe trashëgimia e saj, që bëhet eksper-



imentale, sensoriale dhe afektive përmes fotografisë vishet me kuptime të reja në të tashmen, si kur i referohemi një momenti dhe konteksti historik, ashtu edhe kur

bëhet fjalë për fotografitë vetë? Me çfarë dialogësh kreativë dhe tensionesh etike përballimi kur fotografitë u përkasin kohërave të ndryshme e përmes një logjike rick-

luese, a artikulojnë ata dinjitetin e trashëgimisë kombëtare dhe/ose spektaklin e artit bashkëkohor?

Muzeu “Marubi”, si një hapësirë që ndërton historinë përmes kontributeve të fotografëve, artistëve, kuratorëve apo edhe vizitorëve të tij, është në qendër të një performancë të historisë përmes dixhitalizimit të imazheve të arkivës, duke bërë të aksesueshëm dhe duke inkurajuar qarkullimin e imazheve të papara për dekada të tëra. Çfarë politikash kombëtare dhe identitetesh po vihen në lojë dhe për cilat audiencë: lokale, elitiste, kosmopolite dhe europiane? Si funksionon kjo në raport me një hapësirë për memorien, ambient edukativ apo forma të tjera të përdorimit të trashëgimisë kulturore?

“Vëzhgime kritike të politikave të riqarkullimit të imazheve” dhe “Muzeu ‘Marubi’ si një hapësirë performative” janë dy tematikat që do të trajtohen në një bashkëbisedim mes një grupi të ftuar kuratorësh, artistësh, historianësh e profesionistësh ndërkombëtarë të fushës së artit dhe kulturës.

Përfituesit e këstit të parë dhe të dytë, dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

Ish-të përndjekurit, 2000 trashëgimtarët marrin paratë

Ornela Manjani

Rreth 2000 fëmijët dhe nipërit ish-të dënuarve politikë do të marrin dëmshpërblimin. Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme brenda tre muajve. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të këstit të parë dhe të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. "Lista me përfituesit të cilët janë në radhë për këstin e tyre të dytë, të cilët duhet të përditësojnë numrin e llogarisë bankare si dhe të dorëzojnë fotokopje të mjeteve të identifikimit", - thuhet në njoftimin e dëshëm të Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave: Dorëzoni numrin e llogarisë dhe certifikatat

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një shkronjë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo

prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të cer-

tifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzist-

ojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve, që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

KESTI I DYTE

(Vijon nga numri i djeshëm)

EMER	MBIEMER	Emer	MBIEMER	KOPIE TE LETER NJOFTIMIT	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILJARE	DESHMI TRASHGIMTARE	PROKURE
Alsh	Fejzulla	Shabi	Fejzulla			V	V	V
		Salt	Fejzulla			X Lajev	V	V
		Erfan	Fejzulla	V				
		Taip	Fejzulla	V				
		Rusht	Fejzulla	V	V			
Qazim	Shoti					V	V	V
		Mehmet	Shoti			V	V	V
		Hasan	Shoti	V				
		Vehbi	Shoti	V				
		Rufat	Shoti	V				
		Lutfi	Shoti	V				
		Rakap	Shoti	V				
		Gjinte	Kotarja	V				
		Lumturie	Kuci	V				
		Adem	Shoti			V		ZV
		Hali	Shoti	V				P
		Luzam	Shoti	V				P
		Arif	Shoti	V	V			V
		Nale	Tota	V				P
Zef	Prenga					V	V	V
		Gjela	Doda			X Lajev	V	V
		Marie	Gjokolaj	V	V			V
		Tereze	Lleshi			V	V	V
		Lindita	Dedaj	V	V			
		Marijana	Gjokolaj	X	X			
		Ndre	Lleshi	V	V			
		Rozza	Lleshaj	V	V			
		Frída	Doda	V	V			
		Mirjeta	Sulejmani	V	V			
Iskup	Dushaj					V	V	V
		Fatime	Dushaj			V	V	V
		Ajshe	Haklaj			V	V	V
		Zamir	Haklaj	V				V1
		Mirjeta	Bido	V				P1
		Aranit	Haklaj	V				P1
		Hajrë	Demaj	V				P
		Xhaler	Dushaj			V	V	V
		Mani	Dushaj	V				
		Bedrie	Haklaj	V				
		Isa	Dushaj			V		
		Nadire	Shahaj	V				
		Fadil	Dushaj	V	V			
		Nexhmije	Am	V				
		Besnik	Dushaj	V				
		Merita	Hoxhaj	V				
		Tafë	Dushaj	V	V			
Shefit	Hoxha					V	V	V
		Shaniko				V	V	V
		Rabe	Kamberaj	V				
		Riza	Hoxhaj			V	V	ZV
		Perparim	Hoxhaj	V		V		
		Kujtime	Begaj	V		V		
		Tajana	Ryzaq	V		V		
		Alm	Hoxhaj	V		V		
		Adeina	Bishi	X	X			
		Leonard	Hoxhaj	V		V		
		Veledin	Kristo	V	V			
		Qemal	Hoxhaj	V		V		
		Seter	Hoxhaj	V		V		
		Habibe	Hoxha	V		V		
		Bibal	Hoxhaj	V		V		

EMER	MBIEMER	Emer	MBIEMER	KOPIE TE LETER NJOFTIMIT	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILJARE	DESHMI TRASHGIMTARE	PROKURE
Ali	Kuci	Shpresa	Rreli			V	V	V
		Engjellshe	Majumi			V	V	V
		Aziz	Ruli	V		V		
		Miriam	Ruli	V	V			
		Gracela	Ruli	V				
		Qamurane (Qamir)	Kuci			V	V	V
		Serho (Abi)	Parallangu	V	V			
		Drita	Kuci	V	V			
		Fatmira (Fatime)	Selenica			V	V	V
		Ariana	Borova	X	X			
		Kanarina	Bashari	V	V			
		Kujtim	Kuci			V	V	V
		Ermita	Rreli	V	V			
		Edvin	Kuci	V	V			
		Luan	Kuci					P
		Zhaneta	Cakmakxhan	25/04/1941	V	V		
		Evris	Kuci	V	V			V
Avdulla	Alckoll					V	V	V
		Lumtur	Gjata			V	V	V testament
		Suzana	Bashmili	V		V		
		Donka	Spaho	V		V		
		Xhevisqare (Shives)	Sadikaj	X	X			
		Baki	Alckoll			V	V	
		Luan	Alckoll	V	V			
		Hysen	Alckoll	V		V		
		Sali	Alckoll			V	V	ZV
		Avdulla	Alckoll	V	V			
Malshe	Shupe					V	V	V
		Këze	Shupe			V	V	V
		Fatime	Kaba			V	V	V
		Luan	Kaba	V	V			
		Gezim	Kaba			V		
		Nimete	Zhupa	V	X			
		Qamll	Shupe	V	V			
		Engjellshe	Zhupa	V	V			
Luan	Mane					V	V	V
		Skender	Mane			V	X Lajev	X
		Dhimitri (Hamit)	Mane			V	V	V fotokopje
		Sofia (Marr)	Mane	V	V			
		Elyon (Gen)	Mane	V	V			
		Olgera		V	V			
		Robert	Mane	V	V			
		Tania	Kolonia	V	V			
		Suzana	Mano	V	V			
		Vera	Gogoli	V	V			
Bahri	Samundja (Mukavelati)					V	X-LGje	V
		Muazes	Muco			V	V	
		Tefia	Malsi	V	V			
		Hoshi (Bajram)	Mukavelati			V	V	V
		Merita	Mukavelati	V				P1
		Admir	Mukavelati	V		V		V1
		Lajla	Lako	V				P1
		Agim	Samundja	V		V		
		Isa	Mukavelati	V		V	X-LGje	V
		Anila	Ajari	V				P
		Manjola	Mukavelati	V				P
		Loca		V		V		
		Bynamin	Samundja	V		V		
		Shpresa	Mukavelati	V	V			V
Ndue	Shkurti (Lufi)	509				V	V	V
		Mira	Shkurti			X Lajev	V	X
		Dile	Gjonaj	V	V			
		Gjon	Shkurti	V	V			

Table with multiple columns representing names and dates, containing various entries and their corresponding values.

Table with multiple columns representing names and dates, containing various entries and their corresponding values, including names like Dushi, Dushli, and others.

Opinion *i* Ditës

Dhimbja për detin dhe një histori çame

Nga Gazmir Tahiri

(vijon nga faqja 1)

... nga gjërat më të çmuara të jetës sime, detin dhe çështjen çame, pasi në ADN u përkas të dyjave. Me dhimbje paralelizoj dhe po citoj rrefimin e një vajze që shiste trupin në Spanjë dhe pak ditë më parë u deshifrua në media. "Një klient s'më bëri gjë fare, më tha më jep tangat se do fle me to nën jashtëk, ia dhashë se 5 euro i kisha blerë tek kinezi".

Ndaj dhe të ashtuqajturit përfaqësues të shtetit tim, të flamurit tim, lëshojnë tangat, sepse nuk u janë dashur kurrë gjatë, përveçse në ndonjë gosti perverse dhe se nuk iu ka dhembur kurrë as deti e as çështja kombëtare, pasi ata dhe të tjerë para tyre veç kanë përdhunuar siç kanë dhunuar çdo aspekt të jetës në këtë vend.

DETI

Të rritesh pranë tij dhe të kesh në dyqane vetëm presh, spinaq dhe mish me tollona dhe të vuash për të ngrënë, kam idenë se kjo është cilësi unike e shqiptarëve në glob. Ndaj, deti nuk është konsideruar as nga këta liderë e as nga paraardhësit e tyre si pjesë e jetës së shqiptarëve, është shikuar me neveri si pjesë e telave me gjemba, ku arratiseshin armiqtë e popullit me not, nga vinin armiqtë, kapitalistët që ishin një pasqyrë ku ne shihnim veten dhe na dukej fytyra jonë e shëmtuar dhe nga niseshin trafikantët, prostitutat dhe klandestinët, një pjesë të të cilëve i mbysnim dhe hidhnim dy trëndafilla në det.


Masakruam botën nënujore me aq mundësi sa kishim, mbi 1000 mina antitanke pretendohet të kenë plasur nen det qindra tonelata nitrat, gjer tek një lloj pluhuri që na sillnin italianët e jugut, që e spërkasin mbi ujë dhe bllokonte verezat e peshqve dhe dilnin mbi ujë për t'u grumbulluar.

Rrjedhjet e Bunës, Ishmit e Semanit shkarkojnë dhjetëra mijëra tonë shishe plastike e qese dhe i spërkasin drejt fqinjëve apo në thellësi. Miliona tonelata rrjedhje septike, që duhet të dilnin me filtra 3 ose 4 kilometra në thellësi të detit, pasi të kalonin procesin e klorimit, sot mbysin brigjet dhe helmojnë çdo ambient blu.

Derdhja e Vjosës merr me vete mbetjet e rrjedhura nga shpimet në zonat naftëmbajtëse dhe kur fryn veriperëndim, Gjiri i Vlorës kundërmon si të jetë Patos/Marin-zë.

Kroacia i ka dhënë jetë shumicës së 1100 ishujve që ka, ndërkohe që në Sazanin, vetëm vitet e fundit po arrijmë t'i cojme vizitorë për një 2-oresh transit, pasi kablo elektrik që ushqente Sazanin u kap nga rrjetat e peshkatarëve dhe u shpërthoi në kile pjesë-pjesë.

Pra, ky establishment impotent dhe arrogant që mbyll sytë përballë këtyre krimeve, që lë në pikë të hallit një administratë të tërë detare, e cila është unike në glob,



që paguhet 1 euro për çdo anije që hyn e del kur me 1 euro nuk bën dot as fotokopjet e certifikatave të mjetit, që nuk konsultohet kurrë me praktikantët e fqinjëve apo të homologëve, sepse shumica e titullarëve që mbulonin transportin detar nuk kuptojnë linguistikën e detit në anglisht apo nuk dinë fare anglisht, vallë a do e ketë për gjë apo do i vrasë ndërgjegjja se dhanë 12 milje më shumë apo më pak?

Unë isha një zë i mbytur i kësaj administrate, ndoshta kam edhe unë mëkatet e mia, që 6 vjet nuk kam ngritur zërin kaq fort, por u garantoj që cילו si unë e ndjen

veten në një dhomë më shurdhe, ku secili bën llogaritë e koncesioneve të porteve, të terminaleve, të hidrokarbureve dhe gjëja e fundit që u vjen në mend është deti ku flenë këto blloqe betoni të quajtura porte që operojnë sipas ligjit të xhunglës.

Ndaj, shitja e detit fqinjëve është vetëm konfirmimi përfundimtar me noter i një politike injorimi disa dekadash dhe atyre që iu dhemb deti në shpirt nuk ka çfarë iu dhemb më shumë se kaq, por tregon që këta masakruar të shpirtit të bujku, të naftëtarit, të peshkatarit apo të artistit e kanë shiur

me kohë këtë vend vetëm populli tani ka filluar ta ndjejë realisht.

"ÇËSHTJA ÇAMË"

Unë vij nga një familje çame nga nëna dhe nga baba dhe babai im ka qenë shofer autobusi që ndante oraret apo ditët me një shok të tijn që është ende gjallë, kosovar nga Qerreti i Kavajës që e quanim në shtëpi baca Dulle! Në bisedat nga fëmijëria që më janë ngulitur kosovarët e ardhur në Shqipëri nga koha e Zogut thoshin shqyrr që na erdhën çamët pasi do fillojnë do merren me ata dhe do jemi disi jashtë shënjestrës së regjimit diskriminues. Të gjitha elitat politike në 75 vitet e fundit kanë qenë diskriminuese apo injoruese ndaj çamëve.

Unë s'jam këtu të bëj histori pasi njerëz me një barrë mend, studiues dhe historianë konfirmojnë politikën e kulaçit dhe të kërbaçit ndaj çamëve me shumë pak ndryshim ose aspak ndryshim nga politika që luajti Serbia këto 75 vjet me kosovarët. Por me një diferencë që ndaj kosovarëve në Kosovë aktruan serbët ndërsa ndaj çamëve në Shqipëri aktruan grekofilët sh-

“

Në bisedat nga fëmijëria që më janë ngulitur kosovarët e ardhur në Shqipëri nga koha e Zogut thoshin shqyrr që na erdhën çamët pasi do fillojnë do merren me ata dhe do jemi disi jashtë shënjestrës së regjimit diskriminues. Të gjitha elitat politike në 75 vitet e fundit kanë qenë diskriminuese apo injoruese ndaj çamëve.

qipfolës.

Përfaqësia minimale në elitën intelektuale shqiptare ku edhe ata që ishin nuk konfirmonin të ishin çamë, represioni, targetimi si të pabesë, intriga dhe denigrimi kanë rënë në kurriz të çamëve më shumë se nga çdo grup etnik shqiptar që përbën popullin tonë.

Dhe me e keqja, asnjë apologji, asnjë reflektim njerëzor, por vetëm përdorje, përdorje për vota në zgjedhje, përdorje për vota në parlament, hedhje kockash për t'i targetuar si tepsixhinj mbasi i ke përdorur kur iu ke ngrënë edhe gjer në palcë të drejtat dhe kontrIBUTET e tyre shoqëruar me dy fytyrësinë klasike të këtyre 75 viteve me çamët ujk dhe me greket dele pa zë!

Ndaj si dhe me detin nuk ke ç'ju vret më, ç'ju surprizon më çamëve mbas kësaj sage 75 vjeçare, se i përmende apo se nuk ta mbajti t'i përmendësh në tavolinë me grekët.

Në fund të kësaj tablo të erret, por mbarsur në themel me një krenari që jam një nga pjesëtarët e një grupimi fisnik që quhen detarë, lindur dhe rritur buzë detit dhe ushqyer veten dhe fëmijët e mi me detin por, gjithashtu, vij dhe nga një origjinë fisnike që quhen çamë dhe jo rastësisht se traditën detare në Shqipëri e kanë mbajtur gjallë kryesisht çamët dhe ulqinakët, dua t'i jap një mesazh kujtdo që ulet në tavolinat diplomatike në emër të vendit tim duke i thënë kujdes me detin dhe me çamët pasi të dy faktorët ngrënë aq dallgë të forta sa ta mbysin anijen që i kanë dalë gozhdë tashme!

Dje në "Deutsche Welle"

Me gjithë Brexit-in, ekonomia e Britanisë së Madhe rritet

Nga Erik Albrecht

Për pasoja negative të Brexitit patën paralajmëruar, para së gjithash, mbështetësit e BE. Pasoja negative të daljes nga BE do të ishin masive: recesion papunësi në rritje, rënie të çmimeve të shtëpive. "Britain Stronger in Europe", fushata për mbetjen e Mbretërisë së Bashkuar në BE citonte, për shembull, një studim të shoqatës ekonomike PricewaterhouseCoopers (PwC), në bazë të së cilës pasiguria e Brexitit do të shkatërronte deri në vitin 2020 jo më pak se një milion vende pune britanike. Por në 2017-ën, për shembull, ekonomia britanike u rrit me rreth dy përqind. Kuota e papunësisë ra në nivelin më të ulët që prej më shumë se 40 vjetësh. Kjo në një kohë kur qeveria britanike, një vit para daljes nga BE nuk ka rënë dakord për një plan të qartë për kohën më pas.

RËNIA E PAUNDIT SI NËNË E KONIUNKTURORË

Që pas referendumit nuk ndodhi rënia e thellë, kjo duhet të ketë të bëjë para së gjithash me humbjen e vlerës së paundit britanik, thotë Jonathan Perraton, ekonomist në Universitetin Sheffield. "Pikërisht bizneset prodhuese u forcuuan në këtë mënyrë në aftësinë për të konkurruar". Oliver Gëynne, menaxher i shitjeve të furnizuesi Bronte në Bradford e vë re këtë në biznesin me klientët nga Gjermania. "Shumë firma të mëdha po i rivlerësojnë aktualisht zinxhirët e furnizimit", vëzhgon Gëynne. "Disa pyesin që prej Brexitit: a mund t'i prodhoni me të gjitha në Mbretërinë e Bashkuar, në vend të botës së jashtme?"

QETËSIA MUND TË MOS ZGJASE

"Rri i qetë dhe vazhdo punën", kjo duket se është deri tani deviza e shumë sipërmarrjeve britanike. Megjithatë mbetet të pritet nëse ky qëndrim i çlirët nuk do të ndryshojë, kur Brukseli dhe Londra të



negociojnë këtë vit për detaje të raportit të tyre pas Brexitit.

"Sipërmarrjet vazhdojnë të investojnë shumë pak", vëzhgon Jonathan Perraton. Shumë presin që të bëhen të dukshme pasojat e Brexitit. Edhe rritja ekonomike, thotë Perraton nuk është veçanërisht e lartë përballë koniunkturës së fortë në ekonominë botërore. "Që prej Brexitit, Mbretëria e Bashkuar ka rënë në një nga vendet e fundit në shtetet e G-7-ës."

INFLACIONI ËSHTË RREZIK PËR KONSUMIN PRIVAT

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) sapo e korrigoj prognozën e tij të rritjes për Britaninë për 2019-ën, nga 1,6 në 1,5 përqind. Edhe kjo nuk është goditje e rëndë. Por njëkohësisht, FMN e rriti parashikimin, për shembull, për Gjermaninë, nga 1,5 në 2,0 përqind. "Prodhimi ynë nuk do të pësojë kolaps", thotë Perraton. "Por ne do të kemi përfundime më të këqija se ato që do të kishim pa pa-

sur Brexitin".

Në mbi tre përqind është ngjitur inflacioni në Britaninë e Madhe që prej Brexitit. Ekonomistët bëjnë përgjegjësi për këtë para së gjithash paundin e dobët. Një pjesë e pronarëve i kanë përshatur pagat e punonjësve të tyre. Por shumë britanikë kanë realisht pak para në xhep. Këtë së shpejti do ta ndiejë edhe ekonomia britanike, shprehet Jonathan Perraton. Në fund të fundit, ka qenë konsumi i fortë ai që i ka zbutur deri tani efektet e Brexitit.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

HOROSKOPI

DASHI

Ju shqetësojnë diskutimet me drejtuesin? Rrini të qetë, pasi nuk donte t'ju qortonte, por donte t'ju jepte disa këshilla të vyera. Mund të përmirësoheni ndjeshëm nëse angazhoheni pak, duke bërë që të meritoni ndoshta edhe një rritje rroge.

DEMI

Falë planifikimit të kujdesshëm të çdo angazhimi, sot do të gjeni kohë edhe për argëtim dhe për të qenë pranë personave interesantë. Dini si të jepni maksimumin edhe kur situata nuk do të dukej fare si ajo idealja.

BINJAKET

Disa gëshije burokratike do t'ju mbajnë të tensionuar. Duhet të mësoni t'i menaxhoni duke pasur më shumë zotërim mbi ato aspekte që mund t'ju shkaktojnë tensione. Në vend që të lejoni që t'ju kapë ankthi, përkushtojuni një veprimtarie tjetër.

GAFORJA

Do të përfitorni nga një çast lodhjeje të një kolegu për të treguar besnikëri dhe përgjegjshmëri, duke fituar kështu pikë në sytë e shefit. Të përvshësh mëngët nuk është problem, aq më tepër nëse e dini që do t'ju shpërblehet bujarisht.

LUANI

Të ndriçosh të gjitha zonat e errëta që keni gjetur përgjatë rrugës nuk është e lehtë. Është më mirë të përballësh me gjërat me radhë, sesa të mbash shumë kunguj nën një sqetull. Mos i merrni të gjitha gjërat e mirëqena dhe shikoni përtej asaj çka duket në pamje të parë për të mos gabuar.

VIRGJERESHA

Është dita për të rivendosur harmoninë në çift, nëse, për çfarëdolloj arsye, gjërat nuk po shkonin mirë. Bashkëveprimi i Plutonit dhe Saturnit është në favorin tuaj. Me partnerin dhe në familje do të keni një ambient të shkëlqyer, ku asgjë nuk do t'ju duket e pamundur.

PESHORJA

Lejojeni vetës një pasditë të paqetë, për qetësi absolute. Pozicionimi i Jupiterit në lidhje me Saturnin gjatë mbrëmjes mund të bëjë që t'ju krijohet një gjendje nervozizmi. Mos i shmangni të tjerët, por gjithashtu jepni vetës disa momente qetësie duke qëndruar vetëm.

AKREPI

Duhet të gjeni ekuilibrin e duhur në marrëdhëniet me të tjerët. Jo të gjithë mund të kenë dëshirë të flasin me orë të tëra në rrejtje sociale. Duke punuar për përgatitjen e gjërave të reja, përqipuni të mos shqetësoheni shumë. Mjafton të organizoheni.

SHIGJETARI

Së shpejti do të ndiheni të inkurajuar dhe të qetë, duke qenë se do të gjeni më në fund zgjidhjen e një çështjeje, që po ju shqetësonte prej kohësh. Me të fituar qetësinë, mund edhe të tentoni të rifillonin një lidhje të vjetër.

BRICJAPI

Edha pas një mëngjesi harmonie dhe qetësie, nën ndikimin e bashkimit të Marsit me Venusin, ndikimi i planetëve të tjerë mund të sjellë pak bezdisje. Është mirë të përgatiteni për një mbrëmje jo të qetë. Mbyllini derën dhe ndizni televizorin për t'u argëtuar ndopak.

UJORI

Mos u vendosni shumë kufizime dëshirave tuaja, ndryshe do t'ju duhet të kënaqeni me gjëra të vogla. Ka disa objektiva në profesionin tuaj, që do të donit t'i arritni. Atëherë armatosuni me ngulm dhe vullnet.

PESHQIT

Duke i besuar ndonjë rastësie të fatit do të arrini të mos e ngadalësoni ritmin e punës. Ndoshta fati do të ndërhyjë. Edhe pse jo gjithmonë ia dilni të qëndroni në një hap me kolegët tuaj, mos u shqetësoni. Keni burime të tjera të vyera.

Opinion i Ditës

Ujku, gjurma, pakti detar dhe akti i sotëm diplomatik

Prof. dr. Myslim PASHAJ

(vijon nga faqja 1)

Nga Washington DC, USA.

... diplomatike që bëhen nga Republika e Greqisë dhe ajo e Shqipërisë për delimitimin e kufijve detarë midis të dy shteteve. Le të qetësohemi në përqendrim dhe arsytim... S'ka marrëveshje, askund. Ka vetëm diplomaci dhe instrumente të saj. Ka përcapje që të sillet në tavolinën diplomatike diskutimi i rinisjes së negociatave. Por, ama nuk ka ende negociata të drejtpërdrejta teknike (siç e kuptoj unë). Janë përafime reale, paqësore dhe racionale për të ritrajtuar një marrëveshje, e cila e ka rrënjën në fajin e shtetit shqiptar të kohës së Berishës, që jo vetëm fali detin e shqiptarëve, por përkeqësoi marrëdhëniet me Greqinë.

Shqiptarët dëgjojnë terma të së drejtës Detare Ndërkombëtare të cituara dhe pastaj vënë dorën në kokë dhe komentojnë ashtulllo sa të të luajë tepeleku i kokës. Kriza morale që po kalojmë është duke u thelluar edhe më keq. Shqiptarët me të drejtë nuk besojnë në shtetin e tyre. Ndaj aq shumë reaguim ka pasur, në medime të ndryshme e portale sa s'qenë përfytyruar.

Po komentoj se si është prurë në mendimet tona intervista e ministrit të Jashtëm të Greqisë Kotzias.

1. Pala shqiptare ka pranuar se Greqia ka të drejtë që t'i shtrijë deri në 12 milje ujërat e veta territoriale.

"Është e papranueshme ta sjellësh për shqiptarë dhe grekë këtë deklaratë diplomatike për një çështje kaq të ndjeshme se sa kjo ndarje detare aq shumë të debatuar, pa i bërë sqarimet e duhura. Ka 36 vjet që në UNCLOS (Konventa e Montego Bay) është vendosur e drejta detare e 12 milje detare (22,22 km shtrirje) për shtetet, sikundër edhe për Shqipërinë dhe Greqinë. Si mund të "bisedohet" në këto trajtesa diplomatike për një të Drejtë kaq të njohur të të dy shteteve të cilën nuk e vendosin ata? Nga shumë shqiptarë kjo është kuptuar sikur "Greqia do të marrë 22,22 km det në hapësirën detare!! Ja seç bëhet! Ky standard është ai i Detit Territorial (Territorial Sea = Det Shtetëror) të secilit shtet. Duke filluar nga përmbyllja gjeometrike detare: Othoni-Vijat e Bardha ku përvijon Kanali i Korfuzit i gjithë deti midis nesh është Territorial Sea (Det Territorial) të dy shtetet nuk tejkalojnë 24 milje detare. Otranto dhe ngushtesa e saj ku ndodhet dhe pika "treshë" ka një hapësirë detare ku tejkalohet Deti Territorial 12 milje, ku del në pah, hapësira ekonomike ekskluzive dhe Shelfi Kontinental."

2. I pyetur nga gazetari se çfarë po bëhet me Shqipërinë për zonat



ekskluzive ekonomike, Kotzias është përgjigjur:

"Ramë dakord".

"Ratë dakord?"

"Po", përgjigjet ministri i Jashtëm grek.

"Në vijim ne duhet të shpjegojmë ... se është "rënë dakord" për diçka që "s'është rënë dakord" po ndofta ia vlen që të shpjegohet për grekë dhe shqiptarë se ç'janë standardet e Ligjit të Detit. Kjo të bëhet që të mos interpretohet nga Kazani, intervista e ministrit të Jashtëm grek Kotzias.

Ndaj ne po citojmë për njohje se ZEE janë tej 22,22 km (Det Territorial) dhe po kështu 22,22 km është ZEE (Ligji Detit rrefën se tej 12 miljeve detare vijon deri në 200 milje e kjo shtrirje përbën EEZ brenda së cilës shteti Bregdetar (

Greqia dhe Shqipëria) kanë kontroll mbi peshkimin dhe shfrytëzim të tij.)

Tej 22,22 km (Det Territorial) i cili është ashtu sikundër hapësira tokësore me të drejtat e Sovranitetit në Det dhe Hapësirë Ajrore, vjen edhe një standard tjetër (Deti i Afert) me 22,22 km shtrirje) që përbën vijimin e EEZ. Këto standarde janë të pranishme në Ngushticën e Otrantos midis tre shteteve Itali, Greqi dhe Shqipëri, për të cilën del një problem shumë pikant, mbasi të tre këto shtete edhe pse standardet e Ligjit Ndërkombëtar ekzistojnë, nuk kanë të njëjta rrethana gjeografike, mbasi Greqia përbën në këtë gjeohapësirë një arkipelag ishujsh që s'mund të jenë të njëvlershëm me hapësirën e Dheut Kontinental të Shqipërisë.

Kjo është "thembra e Akilit" e diskutimit jo vet pse Shqipëria ka humbur aq shumë det nga Marrëveshja e parë (që tani nuk ekziston). Pra, besoj se në këto shqyrtime përgatitore është folur për parime dhe standarde, por s'është përgatitur asnjë dokument i shkruar dhe pranuar. Duke besuar edhe Ditmir Bushatin ministrit e Çështjeve Europiane dhe Kotzias se kanë rënë dakord për standarde ndërkombëtare detare si një parapërgatitje, por jo Pakt!

3. Kur thoni "ramë dakord", do t'i shtrini ujërat territoriale në 12 milje? Vijon intervista e Kotzias...

Si mund ta shpjegojmë, pas kësaj këtë shtrirje 12 milje... mbasi tej kësaj nuk ka det Territorial, (sepse ai është vetëm 12 milje) pra kësilloj, këtu nuk është faji i min-

istrit, por i kazarit të lajmeve. Vetëm këtu bëhet fjalë për EEZ (Zonat Ekonomike Ekskluzive) Prandaj shqiptarët e dashur, por që nga pashpjegimi i duhur të ndjeshëm si# janë ndaj çështjes kombëtare, janë gati të ngrihen në kryengritje e të dalin, për shembull, siç i ka lajmëruar një bej të bëjë një miting proteste! Në atë miting mund të shkojë Berisha, Shehu, Meta gjithë negociatorët që presin me veshët ngritur që të ndodhë vijimi i së njëjtës shitje...sepse këta sot e kësaj dite janë mbështetësit e Paktit që s'egziston më. Ç'bëhet në nahijen tonë? Për ta ditur se vetëm në Otranto, siç e shpjeguar atypari bëhet fjalë për EEZ midis të tre shteteve, hapësirat që përfitojnë nuk janë të barabarta, por në vlerësim peshor sipas kushteve (Dhe Kontinental, ishuj, shkëmbinj detarë etj.)

4. Këto janë zonat bregdetare, po do ta bëjmë kur të vijë koha"

Nuk ka "zona bregdetare" por terminologji ndërkombëtare për përcaktimet e Ligjit të Detit. E rëndësishme është të kuptohet nga qytetarët shqiptarë dhe grekë se do t'i vijë koha siç thotë Ministri i nderuar Kotzias që të trajtohen e të negociohen. Kjo është kumti më i rëndësishëm që marrim në këtë parapërgatitje.

5. "Zonën ekskluzive ekonomike mund ta shpallësh kur tjetri ka pranuar që, sidoqoftë, e ke të drejtën për 12 milje."


Sërish jemi në trajtim standardesh ndërkombëtare dhe jo në një Pakt Delimitues Detar. Ne kemi pranuar Detin Territorial 12 milje. Shteti grek e ka pasur sipas ligjit të Brendshëm 6 milje dhe Montego Bay e ka çuar në 12 milje. Mirëpo vini re me kujdes se siç u tha nga Othoni e deri në Ftelia e gjithë hapësira është Det Territorial. Vetëm në Otranto por edhe në Kanalin e Korfuzit, kur të arrihet Pakti do të diskutohet se a janë rrethana të njëjta gjeografike dhe a mund të përfitojë një ishull apo një shkëmb aq sa fiton një Dhe Kontinental? Pakti Greqi - Itali fatmirësisht ka bërë qasjen shëmbëllimore kur nuk i ka dhënë të njëjtën largësi Greqisë në krahasim me Italinë që është Dhe i vijueshëm Kontinental.

6. Domethënë e pranuan?

Kotzias: Po.

Me aq tejdukshmëri sa ka nga këto intervista te hamendojmë se ministrit dhe stafet e tyre diplomatike kanë folur për standarde dhe parime. Këto standarde dhe parime janë zbatuar në disfavore dramatik për Shqipërinë. Në ofiqe se do të bëhet ndonjë miting grektesk e i turpshëm antikomëtar, kryengritës, ma merr mendja se tre nga njerëzit shtetërorë shqiptarë që vijojnë të mbështesin Paktin e Përmbysur janë Salii Berisha, Lulzim Basha dhe Tritan Shehu do të dalin me llogari dhe harta, në mbrojtje të atij Pakti.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë detyrim që paguhet.
5. Ende është ndryshe.
10. Skuadër greke.
11. Agjenci Doganore Sarandë.
14. Duken të gjata në pritje.
15. Derek aktore.
16. Janë në modë.
18. Pak mefistoflike.
19. Inicialet e Mallë regjisor.
20. Ente Monitruuese Durrës.
22. Eshhtë e çuditura.
26. Në mes të Tommy dhe Jones aktor.
27. El Pibe de oro.
28. Janë punëtorë... marksistë.
30. Eshhtë cilësi.
31. Fillojnë ceremoninë.
32. Ngryesem me vërejtje.
33. E kundërta e zenitit.
36. Eshhtë poetik ai i poetit.

37. Power, ish- e Al Bano-s.
39. Muhammad i ringut.
41. Në fillim të vitit.
42. Eshhtë grindje.
46. Janë centralet si Chernobyl.
50. Thurin prapaskena.
51. Të fundit në tender.

VERTIKAL

1. Eshhtë edhe ajo e Mendelejevit.
2. Një erë kafeje.
3. Fillojnë tinëz.
4. Mbahet në polifoni.
6. Eshhtë më e vogël se bashkia një e tillë.
7. Të parat në orkestër.
8. Gibson aktor.
9. Eshhtë festive në festë.
11. Eshhtë si biskote.
12. Shpërthejnë më polemika.
13. Janë si sprova.
17. Sulejmani ish-mestushor.
21. Ulen në parlament.
23. Me Hajriën në balet.
24. Qyteti i FIAT.
25. Rastet pa set.
29. Një as i Real Madrid.
30. Skeda pa kufij.
31. Ishin ndjekësit e Antistenit.
34. Të parat në ambient.
35. Eshhtë gjigant përallash.
37. Martin, regjisor i Norma Rae.
38. Eshhtë letër... kampion.
40. Luajnë pa ujë.
43. Hahen në kufij.
44. Inicialet e Redford.
45. Janë në digë.
47. Diftong poetik.
48. Kufizojnë minutat.
49. Inicialet e Rohmer.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Hasi ish mesfushor.
5. Rrëqethet nga frikat.
9. Fillojnë poshtë.
12. Janë në guvë.
13. Një hektar i shkurtër.
13. Një peshk i rëndë.
14. Një dog që hahet.
15. Qyteti i Scavolini-t.
18. Gjysmë fetare.
19. Janë regjimet dikatoriale.
22. Fise pa fe.
23. Janë këngët me iso.
24. Shkaktojnë avari me punë armiçore.
26. Fillojnë panikun.
27. Ishin ushtarët e Pirros.
28. Eshhtë filozofi e moralit.
30. Filoko aktor.
31. Rrallë është përgjysmë.

VERTIKAL


1. Fillojnë bashkë.
2. Një film publicitar.
3. Kush nuk di... mbytet.
4. Janë si kube.
5. Shkroi manifestin futurist.
6. Të parat në stadium.
7. Fillojë hollë.
8. Mund të jenë dhjamore të tilla.
11. Janë cilësi.
12. Janë drurët si pisha.
14. Eshhtë llogari që qërohet.
16. Qe poetja e Lesbos.
17. Eshhtë infeksion në vesh.
18. Janë indiane ato si sioux.
19. Qe komik i famshëm italian.
20. Inicialet e Kurosawa.
21. Mun të jenë ushtarake.
23. Merren nga kamerieri.
25. Eshhtë bota e luleve.
29. Një shëndeti në tubetë.
32. Me Buenos në Argentinë.
34. Shkurt për kompani.
35. Eshhtë e vogël në Anadoll.
36. Një ditë në mbledhje.
38. Mbreti i Cordelia-s.
39. Eshhtë qelësi i violiënë.
40. Luarasi aktore.
41. Një numër femrash.
45. Italia në Internet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

	9			3			8	
7			6		4			5
			6	9	1	4		
2	4						3	7
		7				1		
1	5						6	8
		4	3		8	7		
9			1		5			6
	6			4			2	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	8	6	9	5	4	7	1	3
7	3	5	8	2	1	6	9	4
4	1	9	6	7	3	5	8	2
1	6	7	5	3	2	9	4	8
8	5	4	7	1	9	2	3	6
3	9	2	4	6	8	1	5	7
6	7	8	3	9	5	4	2	1
9	2	3	1	4	7	8	6	5
5	4	1	2	8	6	3	7	9

Argëtim filozofik

- Fëmijët kurrë nuk kanë qenë të zotë të dëgjojnë të rriturit, por kurrë nuk kanë dëshuar t'i imitojnë ata...
 - Pajpekuria është paafëtesia që dikush të përdorë inteligjencën e vet pa u pirë nga të tjerët.
- Immanuel Kant Filozof
(1724-1804)
- Kur ti je i suksesshëm dashamirët e tu të vertetë e dinë se kush je, por kur je i pasuksesshëm ti din cilët janë dashamirët e tu.



Thënie të mënçura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

15	1	16		17	7		17	3	6	2		
1	7	2	10	3	5	1	6	4	1	6		
	3	7	1	5	2	11	3	4	1	6		
3		1	12	2	9	8	4	1	6	9		
10	3	5	3		3	4	2	6	3	3		
12	9		6		9	8	5	3	5			
1	18		3	9	3		15		1	9	3	
11	1	10	6	2			3		6	2	6	
6	4	6		10	6	2	4	9	g	7		
1	6	3		19	3	4	9	3	a	5	10	
6	1	5	2	6	3	15		6	1	7	3	
6		7	2				15	2	1	6	3	5

M	I	K	E	K	M	S	E			
E	K	A	R	O	M	A	K	E	T	
K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
M	A	T	E	M	A	T	I	K	A	
P	A	S	A	N	I	K	T	A	S	
E	K	U	A	N	E	T	A	R	E	T
R	E	T	E	E	I	R	A	N	I	
I	T	R	B	L	A	K	E	L		
M	I	A	R	E	D	E	K	I		
E	M	E	T	A	L	E	I	S		
T	E	K	E	M	K	U	M	T		
M	O	R	A	V	I	A	M	A	E	

- Ai që i përgjigjet me ligësi mirësisë sate, bëhet mjet për të bërë të njohur mirësinë tënde dhe ligësinë e vet.
- Kurrë s'e bëj gabimin e të debatuarit me njerëz, për opinionet e të cilëve nuk kam respekt. (Edward Gibbon)
- Shkenca nuk ka një dimension moral. Eshhtë e ngjashme me një thikë. Në duart e një kirurgu do të jetë një bisturi; në ato të një vrasësi thika që vret. (Vernon Fon Braun)
- Gjithë lavdia rrjedh nga guximi për t'ia rifilluar nga e para. (Eugjen F. Uer)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

